



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në:

“Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi”

Universiteti i Arteve

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As.Mariana Sinani

Prof.As.Zeni Ballazhi

Prill / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master i Arteve në "Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi"


1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Skenografi - Koreografi
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Arteve në "Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 821, datë 26.12.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 148, datë 19.09.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (dy) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021; 4 studentë; 2021-2022; 10 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-48423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

2



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në kuadrin e akreditimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në “Skenografi-Kostumografi dhe Mësuesi” kërkuar nga Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, është realizuar procesi i vlerësimit respektivisht sipas gjithë procedurave të miratuara.

Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm. Program vjen i riorganizuar nga programi Master i Arteve të Bukura në Skenografi - Kostumografi, licensuar me UMASH Nr 397, datw 10.08.2011, në Master i Arteve në “Skenografi-Kostumografi dhe Mësuesi” me UMASR Nr 821, datw 26.12.2018. Regjistrimi i Diplomës për këtë program u bë me Urdhërin nr.148, dt.19. 09. 2018. Programi përmbush qëllimin dhe objektivat e veta nën drejtimin direkt të Departamentit Skenografi –Koreografi, Fakultetit të Artit Skenik, dhe institucioneve legale brenda Universitetit të Arteve. {Shih RVB, fq.1,}

Formatimi i programit në fjalë, ka ndjekur procedurat ligjore, administrative, akademike në përputhje me detyrimin ligjor {shiko, Evidencë 9. Fq.12} Procedura për formatimin e programit në fjalë i referohet Ligjit nr.8/2015 neni nr. 71, për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë. Diploma dhe formati i saj, dhe tërësia e koncepteve me të cilat operon Programi në fjalë, i referohen dhe e përmbushin në mënyrë adeguate konceptet: lëndë bazë, lëndë integruese, lënde me zgjedhje, praktikë mësimore, grup-lëndor, kopetence profesionale, modul, syllabus, laborator, e tjer. {Shiko Evidencë 11, fq. 1,2}. Programi shtrihet në dy vite akademike në katër semestra dhe përkthehet në 120 ECTS referuar sistemit të Bolonjës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm: Prof.As.Dr. Mariana Sinani dhe Prof.As.Dr. Zeni Ballazhi u angazhuan në cilësinë e ekspertëve të jashtëm respektivisht në dy fusha të dijes me thekse: Artin e Skenografisë dhe të Kostumografisë dhe dijen Pedagogjike e Didaktike. GVJ u angazhua në përgjigje të kërkesës së IAL, Universitetit të Arteve, Fakultetit të Artit Skenik, Departamentit Skenografi/Koreografisë, dhe me vendim të ASCAL.

Ky proces vlerësimi u përmbush nga ekspertët në praninë e specialistit të ASCAL, Znj.Majlinda Demireli. GVJ, mori në analizë kurrikulën e programit, kohështirjen, instrumentet e përmbushjes së programit, profilin e studentëve që përgatiten në këtë program, syllabuset, përthyerjen e tyre në ECTS, praktikat mësimore e profesionale, instrumentet e vlerësimit të studentëve përgjatë programit, performancën e stafit profesional, mjediset fizike ku përmbushet programi, politikat e zhvillimit profesional të stafit, etj. Ekspertët e jashtëm ju referuan detyrimit që të bëjnë vështrime analitike, qasje faktike të situatës, treguesit e matshëm dhe vlerësimin sipas standardeve për kategoritë e përcaktuara në udhëzuesin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kreu viziten në institucion në datat 16,17 Nëntor, 2022, referuar Agjendës së IAL të konfirmuar nga dy institucionet respektive. U organizuan biseda të qëllimta me stafin, studentët, sekretarinë mësimore si dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Koordinimit dhe mbështetjes ndaj Studentëve, Zyren e Burimeve njerëzore, Sekretarinë e institucionit. U selektua në mënyrë të qëllimtë informacion dhe u hoqën paralele mes asaj që gojarisht stafet e përfshira artikuluan dhe dokumentacioni që e dokumentonte referuar RVB. Gjatë vizitës në institucion u kryen vizita të qëllimta studimore në mjediset e bibliotekës, ateljeve, si dhe në hapësirat fizike ku përmbushet programi në fjalë. Gjatë vizitës u asistua në orë mësimi ku dëshmojmë performancën mësimdhënëse dhe mësimnxënëse.

RVJ është projektuar dhe realizuar në respekt të vizitës në Institucion si dhe në respekt të RVB, saktësisht referencat janë marrë nga Evidencat e listuara nga IAL.

Universiteti i Arteve është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 06.04.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 52/33 Prot, datë 07.04.2023. Universiteti i Arteve më datë 12.04.2023, njofton me anë të shkresës Nr. 108 Prot, datë 12.04.2023, "Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit MA në "Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi". Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe vlerësojnë përkushtimin e institucionit për të marrë masa në të ardhmen për të lënë hapësirë e duhur lëndës "Etika dhe Komunikimi", si dhe për ofruar më shumë hapësirë orëve në ECTS dimensionit të edukimit, GVJ i qëndron vlerësimit fillestar, **raporti nuk ndryshon.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në “Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi”


I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Gjatë vizitës së zhvilluar në Institucion, si dhe nga leximi, i RVB-së e konfirmojmë se Programi në fjalë që synon të diplomojë studentë në fushat Skenografi - Kostumografi në Mësuesi, është në rezonancë të plotë me interesat kombëtare, dhe rreket të përmbushë qëllimshëm këto interesa në nivelin akademik, kulturor, në sinergji me konstitutionin shpirtëror shqiptar dhe atë konteporan. <i>{Shih, Evidencë 29. Fq.1 Misioni dhe vizioni i IAL}</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	E konfirmojmë që Programi i studimit në fjalë, është hartuar në përputhje me frymën e institucionit, si institucion kombëtar i konfirmuar për cilësinë e spikatur në disiplinat e artit, dijes artistike, edukimit dhe kërkimit shkencor. <i>{shih Evidenca 29. Fq.2. Plani strategjik i institucionit}</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Programi rezulton të jetë hartuar në përputhje me strategjinë afatgjatë të IAL, Statutit, Rregullores/rregudhoreve, mbi të cilat IAL funksionon si dhe në rezonance me frymen e ligjit për arsimin e lartë. Statusi i vecantë që mori Universiteti i Arteve me Vendimin nr.145, dt.10.03.2021, krijoi hapësira të reja IAL duke ridimensionuar këtë institucion në funksione te reja jo vetëm artistike, por, akademike, kërkimore, educative, mësimdhënëse, menaxheriale. <i>{Shih, Evidencë 21, fq.1,2,3}</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me	Vizita në IAL, na e konfirmoi që ajo çka ishte shkruar në RVB ishte e vërtetë, përtej asaj që pritshmëria jonë si ekspertë ishte të ngrinim “Dyshimin”. Interesat kombëtar pikëpriteshin me prirjet

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	rajonale, globale, dhe referencat ishin njëherësh kombëtare, rajonale, europiane, kontemporane, vetë-zhvilluese dhe konkurruese. Kjo gjendet shprehur qartë, dhe në dokumentet e formuluar në IAL si Statuti i institucionit, por dhe artikullohet në të gjitha bashkëbisedat e realizuara në vizitën në institucion. <i>{Shih, Statuti i IAL, dt.07.07. 2021}</i>			
Konkluzione	<i>Statuti i UAR-it, si edhe Plani Strategjik 2018-2025 theksojnë se qëllimet dhe synimet e UAR-it marrin në konsideratë prioritetet e zhvillimit të vendit dhe interesat kombëtare. Programi i Studimit Master i Arteve "Skenografi - Koreografi dhe Mësuesi" është hartuar në përputhje me aktet kryesore rregullatore të institucionit që janë Statuti dhe Plani Strategjik 2018-2025.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Gjatë vizitës në IAL, bashkëbisedave me stafin, studentët, drejtuesit, si dhe zyrtarët që projektojnë politikën rreth programeve, konstatoam se egziston mjaftueshëm ekspertizë profesionale, përvojë dhe angazhim qoftë nga stafi mësimor, akademik, qoftë nga stafi mbështetës, që garantojnë përmbushjen e programit në fjalë. Fakulteti i Artit Skenik për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 72 pedagogë , nga të cilët 44 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 13 kanë titullin "Profesorë", 15 kanë titullin "Profesor i Asociuar", 8 kanë gradën Dr./PhD, dhe 8 Asistent Lektorë me Msc; dhe 28 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 2 ka titullin

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>“Profesor”, 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”, 3 kanë gradën Dr./PhD. dhe 22 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p><i>(Aneks 187 Tabela Nr. 1 FAS per tre vite akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.</i></p> <p>Ndërsa në Departamentin Skenografi – Koreografi, për vitin akademik 2021-2022, janë 11 pedagogë, si personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët janë 2 me titullin “Prof. Dr”, 8 me titullin “Prof. As. Dr”, dhe 1 me kualifikimin “Master i Shkencave”. Në department janë të angazhuar dhe 8 personel akademik me kontratë (PAK), të gjithë me Master i Shkencave.</p> <p><i>187 Tabela Nr. 1 FAS per tre vite akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Duke verejtur me kujdesin e nevojshëm besoj dhe të mjaftueshëm, konstatoam se: fusha e përgjithshme e studimit dhe ajo specifike ishin në koherencë mes tyre. Fushat ndihmonin dhe ushqenin njëra-tjetrën. Skenografia, Kostumografia dhe Mësuesia potencialisht dhe realisht bashkëveprojnë në këtë program. Ka mjaftueshëm pikëprerje mes tyre. Ato përcjellin komunikimin, dhe mesazhet e kërkuara qoftë në një mjedis specifik që mundet dhe pritet të jete “klasa” si koncept në mësimnxënie, qoftë në një hapësirë më heterogjene që mund të jete një sallë me publik. Thënë e theksuar, programi potencon njëkohësisht një mësues kostumograf dhe një mësues Skenograf. Programi konvergon me frymën europiane të kurrikulave që ofrojnë programe croskurrikulare. Programi në fjalë, ka të trashëguar dhe konsoliduar mësimdhënjen si process universal pasi praktika mësimore në të bërit kostumograf/skenograf kalon përmes proceseve Didaktrike. Kjo e potencon procesin e cuarjes së mësimdhënjes deri në nivelin e Diplomës në Mësuesi</p> <p><i>{Shih, raportet e pedagogut me studentitin}</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë,</p>	<p>E konfirmojmë se programi në fjalë, jetëzon veprimtarinë e tij brenda “habitatit” të natyrshem, duke qene se jetëzohet në fakultetin e Artit Skenik. Ky program ka avantazhin të jete mjaftueshëm i ushqyer në dijen akademike që vjen nga stafi, bashkuar me përvojën e konfirmuar te IAL nder vite, cka në kënd vështrimin tonë, ky program konsiderohet paraprakisht me</p>

përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	shanse. Nderdisiplina, dhe dija e integruar është në natyrën e dijes Skenike, Kostumografike. {Shih- Evidence 44, fq.9}			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	E konfirmojmë se programi në fjalë funksionon në “habitat” e vet. Per këtë arsye dhe të tjera, programi ka mjaftueshëm potencial të vetë zhvillohet natyrshëm brenda fuqisë që prodhon vetë Institucioni. Komponentin që lidhet me shkencat që të bejnë mësues, e ka relativisht mjaftueshëm të zhvilluar vetë Institucioni. Kjo do kuptuar se Diplomimi si Mësues është potencialisht i mundur. {Shih Evidencë 44, plani mësimor, grup-lëndët dhe Syllabuset në Master në Arte}			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	IAL, Potencialisht ofron trajnime profesionale në fushën e Skenografisë dhe Kostumografisë, por kjo nuk u konstatua të ishte pjesë e politikave të Institucionit dhe as të konsiderohej si burim për rritjen e të ardhurave në IAL.			
Konkluzione	Konfirmojmë se: Programi në fjalë ka përputhje të dijes akademike specifike {skenografi/kostumografi} dhe dijes Pedagogjike e Didaktike. Kjo konfirmohet nga RVB ku grup lëndët i konsiderojmë në raport të drejtë mes dijes që të ofron programi për tu diplomuar si Mësues dhe dijes që ky program ofron në thellimin e dijes karakterizuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Dukshëm u konstatua që kishte bashkërendim të institucioneve brenda IAL në funksion të përmbushjes së qëllimit të programit. Konstatuam ndarje adequate të detyrave referuar strukturave në institucion dhe koherencë në cdo veprim të strukturave. Secila struktura njihet sa dhe si struktura tjetër bënte çfarë dhe si...! Ndarja e detyrave dhe përgjegjësia e secilës struktura ishte konform ligjit, në përmbushje të rregullores/ve të brendshme. Veprimtaria e strukturave ndiqte logjikën e rregullave që garantojnë cilësinë e programit. Rregullorja e Programit derivonte nga rregullorja e Departementit, kjo e fundit derivonte nga rregullorja e Fakultetit, gjë që të çon të besosh në koherencën e proceseve.</p> <p><i>{Shih, Evidenca 25-26. Fq.3-4 rregullorja mësimore Evidenca 28, Rregullorja e Masterit}</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Objektivat mësimorë të programit në fjalë ishin produkt i konvergimit të dijes akademike referuar lëndëve karakterizuese dhe dijes në shkencat e edukimit, dijes që të ndihmon të formohesh si mësues. Referuar faktit që pedagogët e artit skenografi dhe kostumografi kanë përcjelle dijen tek studentët ndër vite priremi të besojmë se potencialisht stafi është njëherësh edhe “mësimdhënës” Statusi i ri i IAL, stimuloi marrëveshje dhe memorandume brenda dhe jashtë vendit, gjë që pritet ti rrisë mundësitë për krahasim, konkurrencë, konfirmim të këtij programi. <i>{Shih, Evidenca 39, Marrveshjet nw funksion tw Programit}</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,</p>	<p>Përmbushja e objektivave akademikë dhe objektivave specifike mësimdhënës dhe edukative të programit është parë dhe në aspektin e raporteve ekstra institucionale. IAL, ka sinergji me institucione të nivelit të lartë artistik si Institucione kombëtare TOB, Teatri Kombëtar, Teatrot e tjera, shkolla të arsimit Artistik më profil të konfirmuar kombëtar me të cilat ka raporte retrospektive dhe perspektive. Programi ka garantuar përmbushjen e praktikave mësimore në kuader të diplomimit “Mësues” përmes marrëveshjeve me DAR. Marrëveshjet në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	dimension akademik janë më të theksuara në rastet kur Programi përfiton falë marrveshjeve që potencon Zyra e Projekteve si: Programi Erasmus, Programi Hipa, Jouth Tirana Capital, e tjere. {Shih Evidenca 29}			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia përgjegjëse për programin në fjalë harton dhe dokumenton raporte të cilat dokumentohen dhe bëhen të ditura për të interesuarit në sistemin e brendshëm në IAL, rreth ecurisë dhe përfitimeve nga marrveshjet të projekteve që potencojnë direct programin.			
Konkluzione	<i>Programi ne fjale eshte ne perputhje me misionin e IAL, objektivat e programit jane te qarta. Programi e percjell frymen e ligjit, frymen kombetare dhe konteporane. Programi rregullohet dhe garontohet perms instrumenteve nstitucionale si: Statuti, rregullorja e programit, rregullorja e fakulteteit te cilat jane ne resonance te arsyeshme mes tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË


Standardi II.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

10



Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjisllacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi në fjalë ka një strukturë konform ligjit në fuqi, dhe në përputhje me sistemin European. Programi shtrihet në hapësirë kohore akademike dy vite akademike. Programi është i organizuar në veprimtari akademike, veprimtari ku aplikohet dija e përrhyer në vepër/a artistike, të cilat mund të jenë individuale, apo në grup, për këtë, studentët ushtrohen në rrafshin e leximit, përtpjes se dijes në auditore, si dhe ushtrohen në ateljere specifike dhe mjediset ku konfirmohet performancë skenografike dhe performancë kostumografike, personale apo në grup.</p> <p>Referuar planit mësimor (<i>tabela nr. 6 RVB</i>), vërehet se është bërë ndarja sipas akteve ligjore në fuqi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 29 ECTS Lëndët bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme; - 46 ECTS Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore-artistike; - 19 ECTS Lëndë ndërdisiplinore/Integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje; - 6 ECTS Lëndë plotësuese – gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale; - 20 ECTS Detyrime përmbyllëse – diploma; <p>Programi në fjalë që pritet të diplomojë “Mësues” ka në masën e nevojshme dijen Pedagogjike dhe didaktike. Kjo dije është e përrhyer në 120 - ECTS, referuar normës europiane. Ku një orë mësimore përrhyhet në 50 min. Studenti ka informacionin e mjaftueshëm për detyrimet gjatë përmbusjes në program deri në Diplomim. Gjithçka është e shkruar qartë në Rregulloren Mësimore të Masterit në Fjalë dhe është e vulosur nga Senati.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të</p>	<p>Programi në fjalë, ofron dijen akademike në fushat e Artit Skenografi - Kostumografi dhe “Mësuesi”. Njëherësh Programi garanton në terma të matshëm dhe të vlerësueshëm performancën artistike individuale dhe atë në grup, si dhe performance në fushën e dijes didaktikë e rreth- shkollore.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al





<p>përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Teorite, që lidhen me fushat respektive, tradita, bashke coherenca rajonale, europiane, kopetenca artistike, kopetenca komunikuese, kopetenca transmetuese përcjellëse e arteve në fjalë, shfaqen si objektiva të sofistikuar në programin në fjalë, por teresia e dijes akademike, kopetencës artistike, kopetencës mësimdhënëse janë të legalizuara në Rregulloren e Departamentit dhe detyrimet të studentit. <i>{Shih Evidencë 25}</i>. Ajo që fuqizon dhe potencon shprehinë e studentit janë mjediset ateljere, orët e praktikës mësimore dhe asaj artistike.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi ka të përthyer qëllimin e objektivat e veta në currikulën, syllabuset, orët e ateljerit, orët në funksion të praktikës mësimore, të cilat janë të përthyer në orë mësimore, dhe në ECTS, referuar sistemit europian. Programi ka qartësisht të theksuara orët e praktikës mësimore (150 ore), dhe orët e projektit artistik (260 orë). <i>{Shih Evidencën 44}</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Programi në fjalë, pritet të diplomojë Mësues në Artin Skenografi - Kostumografi në Mësuesi. Ky program është i pari i këtij lloji në sistemin tonë, produkt i politikave të Universitetit të Arteve, dhe të një hulumtimi empirik dhe një kërkimi me instrumente në “terren” pse dhe si mund të përmbushet dija artistike në sistemin e arsimit parauniversitar publik. <i>{Shih Evidenca 29- Misioni- Vizioni}</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me</p>	<p>Programi në fjalë është i shtrirë në dy vite akademike, ngrihet mbi programin Bachelor në Skenografi - Kostumografi dhe ka 120 ECTS. Programi në fjalë ofron disi mjaftueshëm disiplinat</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>të shkencave të edukimit që e potenciojnë studentin të bëhet Mësues. Disiplina si: "Psikologji zhvillimi arti", "menaxhim i mësimit", "zhvillim i kurrikulës", "vlerësim i nxënësit", "shkrimi akademik", e dëshmojnë angazhimin e programit në dimensionin e Mësuesisë. {Shih- Evidencë 44}</p> <p>Por, referuar skemës ku janë paraqitur disiplinat në:</p> <p>Modulin A. ku parashihen lëndët: Histori Arti Bashkëkohor, Shkrim akademik, Metodologji mësimdhënjeje, Teoritë e të nëxënit, Vlerësimi në arsim, Zhvillim Kurrikulës, Psikologji zhvillimi, i gjithë Moduli A. Lëndët bazë ka 29 ECTS.</p> <p>Modulin B. Lëndët karakterizuese, Skenografi dhe Kostumografi marrin 46 ECTS.</p> <p>Modulin C. Lëndët ndërkurrikularë, Ndricim skenik, Inter dezajn, marrin 11 ECTS,</p> <p>Modulin D. Lëndët me zgjedhje, Menaxhim Arti, Kompjuter, Fotografi, Histori Arti Botëror, marrin 8 ECTS</p> <p><i>GVJ Sygjeron referuar detyrimit që ka programi për të diplomuar Mësues mendojmë se ka hapësirë për të ri-parë raportin midis modulit A dhe Modulit C dhe D. Historia e Artit del dy herë dhe në modulin A dhe në modulin D. Duke rishikuar me kujdes konceptin "Menaxhim" në Art dhe Menaxhim të klasës, sygjerohet të shihet mundësia për të lënë hapësirë dhe menaxhimin të klasës. Etika dhe Komunikimi si dimension ku pikëpëritet dhe profesioni i Mësuesit dhe Profili i Artisti, i duhet gjetur hapësirë Brenda Programit kësaj disipline {qoftë dhe në 5 ECTS}. Studentët duhet të marrin njohuri që MAS ka një Kod Etike për Shkollën dhe mësuesin.</i></p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në</p>	<p>Programi në fjalë është i organizuar teorikisht dhe njëherësh përmbushet referuar Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe njëherësh referuar specifikës respektive që përcaktohet nga detyrimi për tu formuar si Mësues në artin e Skenografisë dhe Kostumografisë. Studentët që furnizojnë këtë program janë kryesisht nga Bachelor në artet respektive dhe pjesa tjetër vjen nga trojet shqiptare që kanë kryer studime</p>

Adresa: "Ruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

13

<p>kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>thujse në fusha të përafërta. {Shih - Evidencat e sekretarisë dhe dosjet personale të studentëve}</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>E konfirmojmë se Programi në fjalë që angazhohet të diplomojë Mësues në Skenografi dhe Kostumografi, është i ngjashëm në masë 70% me mastera në fusha të tjera të cilët angazhohen të diplomojnë Mësues. Ky program ofron përmes kurrikulës së tij, disiplina bazale që të bëjnë mësues, si dhe ofron praktikën mësimore që konsiderohet faktor esencial për tu diplomuar si Mësues. {Shih- Evidence 44},</p> <p><i>Por GVJ sygjeron, të shihet nënvizimi ynë më sipër për ti ofruar më shumë hapsirë orë të përkthyer në ECTS dimensionit të edukimit.</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi në fjalë është nënshtruar procesit të Kodifikimit, referuar ligjit të arsimit të lartë.</p> <p>Grup-lëndët, janë të organizuara në blloqet:</p> <ol style="list-style-type: none"> Disiplina bazë, Disiplina karakterizuese, Disiplina ndërkurrikulare, Lëndët me zgjellje, Praktika mësimore, si dhe bashkëngjitur, Sistemi i vlerësimit, Projekti artistic, dhe Tema e Diplomës. <p>Të gjitha janë të përthyer në orë dhe ECTS. {Shih- Evidence 44}</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në</p>	<p>Programi në fjalë nuk është produkt i përbashkët. Ai është produkt vetëm i IAL, Universitetit të Arteve. Por programi në fjalë pritet të pasurohet përgjatë përmbushjes së objektivave.</p>

përputhje me legjislacionin në fuqi.									
Konkluzione	<i>Konfirmojmë Standartin përgjithësisht i përmbushur. Kjo duhet kuptuar se: Programi është në rezonancë me detyrimet e ligjit, shtrihet në hapsirën kohore që kërkon ligji, organizohet referuar ligjit dhe përthyeret në ECTS konform Kartës së Bolonjes. Sygjerohet të merret në konsideratë Kriteri 6 i këtij Standarti.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Në përmbushje</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin në fjalë, ka angazhim periodik, për strukturën akademike, stafin që përmbush programin, afatet, instrumentet e vlerësimit të studentëve, instrumentet e vlerësimit periodik të stafit, praktikat profesionale, praktikat mësimore, informon strukturat vendimarrëse brenda IAL, për ecurinë e programit, informon studentët për raportet e përgatitura dhe organizon procesin e RVB për të kërkuar RVJ, referuar instrumenteve zyrtare të RVB dhe referuar detyrimit ligjor për tju nënshtruar ligjërisht RVJ.</p> <p>Fakulteti i Artit Skenik organizohet në tre njësi bazë, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti Skenografi-Koreografi; 2. Departamenti Aktrim dhe Teori; 3. Departamenti Regji, dhe Regji Filmí & TV; <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Skenografi - Koreografi, i përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr.	2	0	2	0	2	0
	Prof. Asoc.	8	0	8	0	8	0
	Dr./PhD.	0	0	0	0	0	0
	Dr nw proces	0	0	0	0	0	0
	Msc.	1	8	3	6	3	5
	Totali	11	8	13	6	13	5

{Shih - Evidencë 185 Tabela Nr. 2 Skenografi-Kostumografi dhe MÃ«suesi }

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Në nenin 14 të Rregullores së FAS-it parashikohet se pranë FAS-it kryejnë funksionet e tyre: {Evidenca 2.3 VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik}

- Personel ndihmës akademik me karakter mësimor;
- Personel administrative;

Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor-artistik-shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies, projekteve artistike dhe/ose të kërkimit shkencor. Në këtë kategori futen laborantët dhe teknikët. Sekretaria Mësimore është njësi ndihmëse dhe shërbimi, në funksion të procesit mësimor dhe përgjigjet për organizimin dhe mirëfunksionimin e procesit të regjistrimeve, të transferimeve, të provimeve, për procesin e lëshimit të diplomave, si edhe mbajtjen e regjistrave të ndryshëm. Për vitin 2020-2021, numri i personelit ndihmës akademik është 8.

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një

Referuar RVB-së, departamenti ka caktuar një person në rolin e koordinatorit, i cili emërohet me vendim të dekanit. Në rregulloren e Departamentit, në nenin 9 dhe 10 të saj parashikohen edhe ngritja e grupeve mësimore-artistike-



person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	kërkimore brenda departamenteve si edhe funksionet e drejtuesit të grupit mësimor. Përgjithësisht rolin e koordinatorit të Programit të Studimit e luan pedagogu që është caktuar edhe kryetar i grupit mësimor për këtë program studimi. <i>{Evidenca 2.4.3 Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme e Dep. Skenografi_Koreografi}</i>			
Konkluzione	<i>Konfirmojmë Standartin përgjithësisht të përmbushur. Kjo duhet kuptuar që ky program përmbush detyrimet shkallen e kualifikimit të stafit akademik, ka strukture referuar ligjit menaxhohet mire nga njesia baze përgjegjëse për përmbushjen e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia përgjegjëse për programin në fjalë disponon informacionin e nevojshëm rreth strukturës përmbajtjes së programit. Programi i studimit Master i Arteve në Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi përmban Rregulloren e programit me elementët përkatës që nga objektivat e programit dhe deri në diplomimin e studentëve; planin mësimor të detajuar me lëndët të ndara në orë në auditor dhe orë jashtë auditorit, të shoqëruara edhe me ECTS për çdo lëndë; syllabuset e lëndëve të paraqitura në planin mësimor; modelin e diplomës dhe suplementin e diplomës.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën	Plani Mësimor është i strukturuar në formatin që kërkon ligji: Organizimi në disiplina bazë, disiplina karakterizuese, disiplina nderkurrikulare, disiplina me zgjellje, praktikën mësimore, projektin artistik, temën e diplomës. Plani është i përthyer në semestra, në javë mësimore, ore mësimore, dhe në ECTS. Plani mësimor është i detajuar sipas një skeme ku paraqitet listë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

17

mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	konceptet e lëndës, literaturë, detyrimet e studentit për të shlyer përmbajtjen e disiplinës, format e vlerësimit deri penaliteti në rastet kur nuk përmbushet programi lëndor. {Shih - Evidenca 44-plani mësimor}
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve tregohen në Rregulloren e FAS-it si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Në këto rregullore përcaktohen midis të tjerash kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit si edhe kriteret për transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve; ndërrimi, ekuivalentimi i programit dhe apelimi i vendimit të marrë. {Shih Evidencë 2.3; Evidencë 25, rregullore e Masterit}
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi është i organizuar në syllabuse të detajuara për cdo lëndë, përfshi dijen teorike, dijen që përvetësohet përmes ateljesëve, performancën, orët e detyruara në mësim, orët individual, sistemin e vlerësimit periodike dhe sporadic etj. Në cdo syllabus jepet, emërtimi i lëndës, forma e zhvillimit të saj, numri i krediteve dhe numri i orëve mësimore në klasë; ndarja në orë leksioni dhe orë seminari, konceptet themelore dhe termat bazë të lëndës; temat e lëndës të ndara në kapituj; forma e kontrollit të dijeve dhe frekuentimi; sistemi i vlerësimit; literatura bazë dhe ajo e detyrueshme. Të gjitha syllabuset janë në një format unik. {Shih - Evidencën 44}
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Potencialisht dosja përmirësohet dhe pasurohet gjatë procesit. Në parim kjo është dhe detyrim ligjor i drejtuesve. Kjo u konfirmua nga bashkëbiseda me drejtuesit. Por, në programin në fjalë ende nuk konstatoam të kishte lindur nevoja për ndryshime aktuale.
Konkluzione	<i>Konfirmojmë standartin e përmbushur. Kjo do të thote që Plani mësimor është i strukturuar dhe merr në konsideratë 4 blloqet disiplina baze, Disiplina karakterizuese, Disiplina integrale,</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<i>Disiplina me zgjedhje. Syllabuset jan hartuar conform skemes qe parashikohet ne ligjin respektiv.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4


Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i Programit Master në Arte: Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi, e gjejmë të arsyeshëm dhe ligjërishit korrekt. Dimensionin e Edukimit konsiderohet i plotë, në kuptimin që studentin merr mjaftueshëm dijen pedagogjike dhe didaktike për tu bërë Mësues. Kurrikula e profesionit të mësuesisë është funksionale, ajo zë 70% të kurrikulës në total, bashkëngjitur dhe me orët e praktikës mësimore {150 orë} e vlerësojmë si të mjaftueshme për punësimin e të diplomuarit në sistemin shkollor. <i>{Shih- Evidencën 44}</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Kurrikula gjendet e formatuar në: Lëndë bazë, Lëndë karakterizuese, Lëndë kroskurrikulare, Lëndë me zgjellje, dhe praktika mësimore. Çdo lëndë është e fragmentuar në qëllime, objektiva, tema, metodologjinë e përvetësimit, literaturën, rezultatet e pritshme të të nxënit si dhe format e vlerësimit të studentit apo të grupit në varësi të detyrave që janë planifikuar në kurrikul. Gjithçka gjendet e shkruar në dokumentet e paraqitura në Dosjen e vetvlerësimit. <i>{Shih RVB, Evidencë 44 dhe Rregulloren mësimore}</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e	Struktura e Programit Master në Arte "Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi" shtrihet në semestra, përthyeret në javë mësimore, në tema, koncepte, detyra individuale/grup referuar specifikës së disiplinës dhe profilit të programit. Referuar faktit që ky program


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Master në Arte dhe Mësuesi, ka specifika të theksuara pasi pikëpriten disiplina të ndryshme në funksion të mësuesisë, qartazi janë specifikuar aftësitë dhe kopetencat profesionale që pritet të fitojë studenti deri në marrjen e Diplomës. {Shih Evidenca 44}</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>E konsiderojmë që Programi me mënyrën e strukturimit, me llojin e disiplinave që përfshin, është i transferueshëm. Ky program hartuar në respekt të ligjit dhe detyrimeve që ka karta e Bolonjës garanton mobilitetin e studentëve. Programet lëndore të Programit të Studimit Master i Arteve “Skenografi Koreografi dhe Mësuesi” mundësojnë punësim në një sërë profilesh dhe profesione, përfshirë edhe mësimdhënien. Gjithashtu, UART-i ka marrëveshje në kuadër në Programit Erasmus+, gjë që mundëson mobilitetin dhe shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve. {Shih Evidenca 39}</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Syllabuseve, pika e literaturës ishte e pasur dhe e përditësuar. Literatura ishte nga autorësi shqiptare dhe e huaj. Literatura sygjerohej fizike, pamore dhe online. Kjo mundëson zhvillim të kopetencës mësimdhënëse dhe kopetencës artistike.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Konfirmojmë se programi në fjalë ishte ndërtuar në tri pista themelore: Dijen teorike, Aftësitë artistike, Kopetencën në mësimdhënje. Oret në funksion të praktikës mësimore, oret në funksion të praktikës profesionale, potencojnë aftësinë dhe kopetencën. Konstatohet se lëndët e zgjedhura, emërtimi dhe përmbajtja e programeve lëndore, vlerësimi në kredite, si edhe shpërndarja lëndë teorike/praktike mundëson arritjen e</p>

	objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. {Shih Evidencë 44}			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi në mënyrën si është ndërtuar, në mënyrën si menaxhohet nga stafi, në mënyrën si përmbushet nga studentët, potencon dhe garanton punësim të studentëve në sistemin e Arsimit parauniversitar. Vetë emërtimi i programit të studimit si Program i Studimit Master i Arteve “Skenografi Koreografi dhe Mësuesi” lejon studimin e njohurive dhe aftësive që i referohen një diapazoni të gjerë mundësish studimi dhe punësimi, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, përfshirë edhe mësimdhënien.			
Konkluzione	<i>Standarti II.4 është i përmbushur. Kjo nese i referohemi faktit që ky program Master në Skenografi & Kostumografi dhe Mësuesi, ka specifika të theksuara. Ne program pikëpëriten disiplina të ndryshme por në funksion të mësuesise. Por, qartazi janë specifikuar kopetencat profesionale që pritet të fitojë studenti deri në marrjen e Diplomës si Mesues ne Artin/tet respektiv.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin	Për çeljen e Programit në fjalë, ka pasur analiza empirike dhe faktike të tregut. Nevoja për mësues që zhvillojnë disipinat e artit në gjithë sistemin parauniversitar është konsideruar si argument substancial për të prodhuar diplomën e Mësuesit në Arte. IAL është mjaftueshëm qartë dhe e vendosur të Diplomojë Mësues në Arte. Kjo nga bashkebisedat përgjatë vizitës në datat 16 dhe 17 nëntor, por gjendet mjaftueshëm e elaboruar në RVB.


Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

21

<p>parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>									
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni angazhohet të ndjekë dhe të nxisë studentët e diplomuar sa i përket punësimit real dhe potencial. Gjatë bashkëbisedës me studentë, konfirmojmë se ata, ishin një nga burimet racionale që sillnin problematikat e tregut të punës në Fakultet. Staf i nxiste procesin e reflektimit ndaj problematikave dhe ndiqte procedurat institucionale për ti shëndruar këto problematika në objektiva mësimore.</p>								
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin përcjell përmes procedurave të rregulluara në rregulloren e Institucionit dhe në rregulloren e Programit, tek kordinatori i programit propozime që vijnë nga studentët apo pjestarë të stafit, në funksion të pasurimit të programit. Konstatuam se ende programi në fjalë nuk ka kontakte me Urrdhërin e mësuesit si profesion i rregulluar.</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi funksionon në hapsirat e lirise akademike. Si liria per te aplikuar metodologjite e te nxenit, studentet kane hapësire per te aplikuar intresat e tyre ne fushat e artit dhe te mesimdhënjes dhe kjo shihet e garantuar ne rregulloret respective.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="571 1597 738 1697">Përmbushet</th> <th data-bbox="738 1597 930 1697">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="930 1597 1137 1697">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1137 1597 1401 1697">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="571 1697 738 1760"></td> <td data-bbox="738 1697 930 1760"></td> <td data-bbox="930 1697 1137 1760"></td> <td data-bbox="1137 1697 1401 1760" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						





Standardi II.6**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi ka të qartë objektivat e studimit dhe destinacionin përfundimtar të programit, diplomimin Mësues në Arte. Qartësi e destinacionit të programit është në të gjitha dokumentet institucionale që prodhon IAL në funksion të programit. Kurrikula dëshmon qartësisht qëllimin e programit. <i>{Shih Evidencë 44}</i> Rregullorja mësimore qartësisht thekson objektivat e programit, Rregullorja e studentit gjithashtu.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Parimi i lirisë akademike të personelit akademik të UART-it pasqyrohet në Statutin e UART-it, si edhe në Rregulloren e FAS-it, Kështu, në Statut në nenin 6 të tij theksohet:</p> <p>Liria akademike garantohehet nëpërmjet të drejtës:</p> <p>a) për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-artistike dhe shkencore;</p> <p>b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit;</p> <p>Ndërsa në nenin 5 (Liria akademike) të Rregullores së FAS-it, përcaktohet se”:</p> <p>“Personeli mësimor shkencor në FAS gëzon liri akademike në procesin mësimor-artistik dhe në kërkimin shkencor. Liria akademike nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së ideve, opinioneve, metodave të punës akademike. Garanton zhvillimin e lirë, kritik e krijues të mësimdhënies, të kërkimit artistik-shkencor si edhe të shërbimeve në përputhje me standardet e cilësisë. Liria akademike ushtrohet në përputhje me planet dhe programet mësimore të hartuara dhe të miratuara nga ky fakultet. <i>{Evidenca 1.15.2}; {Evidenca 2.3};</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi është i ndërtuar në mënyrë të tillë që studentët të jenë të motivuar të angazhohen në projekte artistike brenda fakultetit dhe jashtë tij. Referuar marrëveshjeve që ka bërë Institucioni, studentët angazhohen në veprimtari kërkimore e artistike.</p>

<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Shërbimet financiare në UART janë të përqëndruara në vetëm një njësi, siç është Drejtoria Financiare. Kjo Drejtori është në varësi të Administratorit të UART dhe vetë Administritori është në varësi të Bordit të Administrimit.</p> <p>Drejtoria ekonomike parashikon çdo vit akademik mbështetje financiare të Fakulteteve përbërëse të UART. Këto Fakultete përcjellin në Drejtorinë ekonomike, sipas kërkesave të Departamenteve të tyre nevojën për mbështetje financiare për aktivitete të ndryshme artistike, apo edhe aktivitete studimore.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Standardi II.6 është i përmbushur. Kjo duhet kuptuar referuar faktit qe: Njesia ekonomike parashikon çdo vit akademik mbështetje financiare të Fakulteteve përbërëse të UART. Këto Fakultete përcjellin në Drejtorinë ekonomike, sipas kërkesave të Departamenteve të tyre nevojën për mbështetje financiare për aktivitete të ndryshme artistike, apo edhe aktivitete studimore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.7</p>	
<p>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Programi në fjalë është specifik. Aty, pikë priten dy fusha të dijës ajo artistike dhe ajo e shkencave të edukimit, e cila, është vetë një dije ndërkurrikulare, është dukshëm dije e sofistikuar, që kërkon metodologji të sofistikuar për tu transferuar tek studentët.</p> <p>Pranur këtë fakt, stafi akademik dhe studentët janë gjithmonë në një proces kërkimi dhe hulumtimi për gjetje të reja dhe identifikimin e një gjuhe të re artistike. Njësia përgjegjëse, mbështet Stafin që të përmbushen objektivat e listuara në sylabuse dhe ndjek ecurinë e tyre në proces. Këtu bëhet fjalë për kërkim të një natyre specifike, që është kërkimi artistik dhe dija</p>

<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>edukative. Ajo që konstatuam ishte, formimi i nevojshëm dhe i mjaftueshëm i Stafit për pritshmëritë tek studentët.</p> <p>Për shkak të veçantisë së UART-it, është karakteristikë e veprimtarisë së tij mësimore dhe jashtë auditorit organizimi dhe pjesëmarrja e aktiviteteve të llojeve dhe natyrave të ndryshme, të gërshetuara me procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Referuar specifikës së programit në fjalë, Njësia përgjegjëse identifikon modulet për të organizuar jo konferenca në kuptimin e parë dhe literal të fjalës, por veprimtari të përbashkëta të natyrës shfaqje, zberthim të veprës artistike, zberthim të veprës në këndvështrimin e Kostumografisë, në kënvështrimin e Skenografisë dhe në këndvështrimin e Mësimdhënies. Kjo dije e pikëprerë ndihmon studentët të thellojnë dijet artistike në aspektin e transferimit didaktik.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>E vlerësojmë programin në fjalë, si mjaft ambicioz, i mundshëm për tu përmbushur, Programi, konsiderohet i transferueshëm dhe konkurent në tregun vendas dhe në tregun ndërkombëtar të punës. Programi i Studimit është riorganizuar në bazë të Urdhërit të MASR nr.821, datë 26.12.2018, me qëllim që të gjithë programet e mëparshme të studimit të përshtateshin edhe në programe në fushën e mësuesisë. FAS-i ka rishikuar në mënyrë të vazhdueshme kurrikulat e programeve të ciklit të dytë, me qëllim që t'i paraprijë kërkesave të fushës dhe të tregut artistik të brendshëm dhe të jashtëm.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin është mjaftueshëm e familjarizuar me veprimtarinë e shoqatave artistike, rrjeteve profesionale, me list-kopetencat e nevojshme që të çojnë në marrjen e licencës në profesionin e mësuesit në artet Skenografi dhe Kostumografi.</p> <p>Njësia përgjegjëse njih hapsirat kurrikulare të arsimit parauniversitar nga klasa 1- te klasa 12, ku zhvillohet dija artistike dhe specifikat e kësaj dijeje shkollore.</p>

profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.				
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit Master i Arteve në Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi është licensuar për tu ofruar edhe në fushën e mësuesisë duke u riorganizuar si i tillë në 2018 (Saktësisht Urdhëri i riorganizimit Nr 821, datë 26.12.2018) programi është hartuar dhe është njohur nga Ministria e Arsimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend. Pjesa e mësuesisë e këtij programi bën pjesë në profesionet e rregulluara. Gjithësesi, profesioni i mësuesisë është në listën e profesioneve të rregulluara, dhe njësia përgjegjëse për programin ishte e njohur me gjithë proceset që legalizojnë marrjen e licenses dhe futjen në system të mësuesve që pritet të diplomojë programi në fjale.			
Konkluzione	<i>Standarti i mësipërm rezulton të jetë i përmbushur. Programi e ka bere mjaftueshem ndergjegjesimin e vetvetes dhe te studenteve per Profesionin e Mesuesise si profesion i rregulluar.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies	Format e mësimdhënjes, janë të listuara në mënyrë specifike në rregulloren e brendshme të Fakultetit, dhe detajohen dhe në



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-48423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

26

<p>dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/usetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Rregulloren Mësimore, si dhe ri-merren në të gjitha formatet e vlerësimit që bën NJSBC ku chekohet cilësia e mësimdhënjes. <i>{Shih- Evidence 76, fq.27}</i>, ku listohen përgjigjet e studentëve për aplikimin e formave të mësimdhënies dhe kontroldhin e dijeve. Format e mësimdhënies janë: Leksioni, seminarët, punët në ateljer, praktikat profesionale, praktikat mësimore. Gjithashtu, edhe në nenin 23 të Rregullores së Departamentit të përcaktohet se format kryesore të punës në departament janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, laboratorët, praktikat lëndore, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Stafi akademik ushtron mësimdhënjen në frymën e lirisë akademike, parim i cili udhëheq gjithë veprimtarinë mësimdhënëse, por parim i cili mbahet në fokus përmes formave dhe instrumentëve të vlerësimit nga jashtë që janë studentët, të cilët së paku dy herë në vitin akademik përmbushin pyetjet në pyetësorët që kontroldhojnë cilësinë.</p> <p><i>{Shih Evidencë 76}</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>IAL mbështet stafin akademik dhe mësimor në pasurimin e metodologjive mësimdhënëse dhe kopetencave didaktike. Kjo konfirmohet nga bashkëbiseda e qëllim të gjatë vizitës në institucion por dhe nga Marrëveshjet e Institucionit me Fakultetin e Shkencave Sociale, ku fokusi i marrëveshjes është: Trajnimi në fushën e Mësimdhënjes dhe të mësuesisë në përgjithësi. <i>{Shih Evidence 76}</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p>	<p>Bashkëbiseda me stafin akademik, si dhe bashkëbiseda me studentët na mundësoi të mbërrinim në besimin se stafi akademik zotëron dijen respektive, artistike/edukim në nivelet e mjaftueshme. Por, referuar RVB, konfirmojmë se në raportin e organizuar nga NJSBC për kontroldhin e dijes nga ana e studentëve, shkruhet: 70% e studentëve vlerësojnë {+} format e mësimdhënjes, 40% e studentëve vlerësojnë {+} stafin në rrafshin didaktik, 55% e studentëve vlerësojnë {+} objektivitetin e dijes.</p> <p><i>{Shih-Evidencë 74}</i></p>






<p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>E konfirmojmë që Studentët janë faktori i fuqishëm në vlerësimin e mësimdhënies. Ata përfshin në këtë proces referuar detyrimin që vjen nga rregullorja e Fakultetit dhe e Programit për tu përfshirë në këtë proces.</p> <p>Rezulton se në fund të çdo viti akademik zhvillohet edhe një sondazh, përmes përdorimit të pyetësorëve me studentët, me qëllim marrjen e mendimeve të tyre përmes lidhur me vlerësimin sipas fushave të Programit të Studimit dhe të Mësimdhënies. Sipas pyetësorit janë marrë mendime nga studentët, midis të tjerash, lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimin e organizimit dhe të shpërndarjes lëndore; - vlerësimin dhe organizimin e formave të mësimdhënies; - mbështetjen didaktike; - mënyrën e kontrollit të njohurive; - bashkëpunimin me stafin akademik; <p>Rezultatet e vlerësimit bëhen me indikatorë të formatuara dhe legalë, zyrtarisht i përcillen strukturave në nivel fakulteti dhe merr fidebec për më tej.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të</p>	<p>Nga takimi me Dekanin por edhe me Shefin e Departamentit, konfirmojmë se veprimtaritë e përbashkëta artistike të studentëve dhe pedagogëve, si dhe veprimtaritë në bashkëpunim me Departamentet e tjera të FAS por edhe me Departamentet e Fakulteteve të UART, janë një nga format e veçanta të mësimdhënies për këtë program studimi. Metodot interaktive janë pjesë e rëndësishme e përmirësimit të aftësive të mësimdhënies. Në fushën e edukimit janë mundësuar disa trajnime, duke patur si qëllim ngritjen e nivelit të mësimdhënies. Këtë na konfirmuar edhe takimi që patëm me stafin e programit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.							
Konkluzione	<i>Standarti i mësipërm rezulton të jetë i përmbushur. Kjo duhet kuptuar qe: Metodologjite e permbushjes se programit jane ne fokus te prokupimit te stafit. Metodologjite deriovojne nga specifikat e disiplinave dhe te sylabuseve. Megjithese ata jane ne cdo sylabus te parashikuar mund te apdejtohen ne varsei dhe te konteksit te detyres mesimore.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th><i>Përmbushet pjesërisht</i></th> <th><i>Përmbushet kryesisht</i></th> <th><i>Përmbushet plotësisht</i></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	<i>Përmbushet pjesërisht</i>	<i>Përmbushet kryesisht</i>	<i>Përmbushet plotësisht</i>			X
<i>Përmbushet pjesërisht</i>	<i>Përmbushet kryesisht</i>	<i>Përmbushet plotësisht</i>					
		X					



Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	E konfirmojmë se Rregullorja e Programit ka të qarta format e testimit dhe kontrodhit të njohurive, aftësisë dhe kopetencës profesionale dhe kopetencës mësimdhënëse. Rregullorja është e njohur nga studentët dhe Kodi i Etikës ju njeh të drejtat si studentit dhe stafit.ka disa forma kontrolli: Testi online {Shih-Evidence77} Manuali i Testimit Microsoft Teams., si dhe format e kontrollit të drejtëpërdrejte, individuale, apo në grup e tjera.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve	Nga takimi me studentët e konfirmojmë se ata ishin në dijeni të mënyrës si do të bëhet kontrolli i dijes në çdo sylab referuar specifikës që ka vetë syllabusi. Organizimi dhe paraqitja e çdo programi lëndor është hartuar në përputhje me VKM nr.41 datë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga IAL-të” dhe çdo program lëndor paraqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numrin e krediteve; - Numrin e orëve mësimore; - Format e mësimdhënies; - Përmbledhjen e lëndës dhe rezultatet e të nxënit; - Konceptet themelore dhe termat bazë të lëndës; - Temat e lëndës; - Forma e kontrollit të dijeve; - Kontrolli i vazhdueshëm përmes elementëve të caktuar; - Sistemi i vlerësimit të studentëve; - Literatura; <p>Format e kontrollit dhe vlerësimit gjenden në çdo sylabus, referuar specifikës, ndërsa rregullorja e Programit i jep fuqi administrative sistemit të kontrollit dhe vlerësimit.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Programi në fjalë në respekt të natyrës specifike të tij ku pikëprehen tri dije të ndryshme, studentit i ofrohen mundësi të vecanta për të demonstruar dijen teorike, aftësi dhe kopetencën profesionale. Kjo mund të demonstron individualisht ose në grup, në varësi të detyrës apo projektit të dhënë. Në UART njihen edhe disa mënyra të tjera të organizimit të provimit të tilla si provimi i lëndës speciale individuale, provimi me shkrim me një kohëzgjatje të paracaktuar, provim me shkrim dhe me gojë (ku provimi me shkrim është parakusht për të hyrë në provimin me gojë), provim në grup ose individual në realizimin e veprave atistike sipas programit të miratuar, provim me detyra dhe projekte kursi.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Standardi III.2 është i përmbushur. Programi është i qarte mjaftueshem per Temat, format e kontrodhit, sistemin e vleresimit, konceptet referuar cdo disipline, kopetencat qe student pritet te permbushe, literatures e tjer.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive është i parashikuar që në kurrikulën e lëndës. Referuar specifikave të grup-lëndës, janë dhe format e kontrodit, testimit, dhe vlerësimit. Këto janë të fiksuara dhe në rregulloren e programit dhe studentët janë të familjarizuar me to. Edhe vlerësimi përfundimtar është i fiksuar në fund të cdo syllabusi. Format e vlerësimit dhe sistemi i pikëve është në rregulloren e programit dhe në syllabus. Ato janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: 10%- Puna e pavarur krijuese: 20%- Detyrat e kursit: 20%-- Projektet e kursit: 20%- Provimi përfundimtar: 30% <p>{Shih-Evidencë 76, fq. 27}{Evidencë 77.}</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në funksion të vlerësimit dhe testimit në këtë program është sistemi online i vlerësimit system i cili ruan dhe confidentialitetin e testit dhe i shërben kodit etik të raportit pedagog-student.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i studentit në lëndë bëhet referuar specifikës së syllabusit. Forma e vlerësimit është e parashikuar dhe studenti e din paraprakisht. Forma e vlerësimit të paraparë në syllabus i referohet ligjit dhe referohet specifikës së sylabusit.</p> <p>Referuar Rregullores së Programit të Studimit, vërehet se Praktika profesionale dhe diplomimi realizohej nga komisione të ngritura në mënyrë të posaçme. Provimi i Diplomës kryhej në format e mëposhtme:</p>



	<p>a) Mbrojtja artistike e diplomës.</p> <p>b) Paraqitje e diplomës me tekst.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i studentit është objektiv në kuptimin që studentin ka dije se për çfarë do të vlerësohet. Në rast të mos pajtimit me vlerësimin studentin gëzon të drejtën e kundërshtimit të vlerësimit. Kjo e drejtë është e parashikuar në rregulloren e programit. Pedagogu ka detyrimin të ndihmojë studentin të kuptojë vlerësimin dhe të përmirësojë performancën në një rast të dytë.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Plagjiturat janë të ndaluar. Në rastet kur kjo dokumentohet studentin penalizohet sipas parashikimit në rregulloren e Institucionit. Në Kodin e Etikës të UART-it, në nenin 17/g theksohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët duhet të mos kopjojnë, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, si edhe të mos shmangen nga shlyerja e detyrimeve mësimore; <p>Në Rregulloren e Programit të Studimit, në nenin 21/9 përcaktohet se:</p> <p>Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve. Studentin që në provim përdor formë e mjete të palejueshme, largohet nga provimi dhe konsiderohet i vlerësuar negativisht;</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit për studentin janë të parashikuara që të jepen brenda një afati kohor të parashikuar në rregulloren e institucionit. Në rregullore janë të parashikuara dhe afatet e mos-pajtimit. Kontrolli bëhet për dijen teorike, performancën artistike dhe për kopetencën mësimdhënëse. Rezultatet e kontrollit përcaktohen në nenin 21 të Rregullores së Programit të Studimit. Sipas kësaj rregulloreje, në të gjitha format e organizimit të provimit, studentin merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se tre ditë pune nga data e dhënies së provimit. Në raste të jashtëzakonshme, shtyrja e dhënies së rezultatit bëhet me vendim të Dekanit.</p>



<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>E konfirmojmë që të gjithë dokumentet me bazë ligjore dhe administrative të institucionit, duke filluar nga Statuti, rregulloret, Kodi i Etikës, kanë të paraparë në mënyrë të detajuar procedurat e vlerësimit të studentit. Liria akademike e Stafit akademik në aspektin e vlerësimit është e kontrolluar vetëm si procedurë. Ajo është një çështje që zhvillohet nga pedagogu të studenti dhe mbetet kopetencë e pedagogut.</p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në nenin 21 të Rregullores së Programit të Studimit, përcaktohet se në rastet e kontestimit të rezultatit, në komision duhet të marrë pjesë edhe përgjegjësi i njësisë-bazë, për të monitoruar transparencën e procesit. Në përfundim të procesit të rishikimit, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë. Gjithashtu, studenti ka të drejtë që të ankohe, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose është bërë vlerësim i pamërituar për përgjigjen që ka dhënë ose për performancën artistike që ka realizuar. Ankesa duhet të depozitohet brenda një afati 24 orësh nga shpallja e rezultatit. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime komisionin e provimit dhe vetë studentin dhe pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë brenda tre ditëve.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Standardi III.2 është i përmbushur. Kjo duhet kuptuar qe: Programi permbushet ne frymen e Etikes dhe lirise se studenteve per te kerkuar hapesirat e tyre vetzhvilluese. Kontroldhi i dijës behet i hapur perms testeve, detyrave, sistemi i vleresimit eshte legal, por ruan dhe privatesine e studentit dhe garanton ankimimin.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi në fjalë thellon njohuritë që studentët kanë marrë në nivelin Bachelor në disiplinat e Skenografisë dhe kostumografisë. Kjo referuar krahasimit me dijen e marrë në tri vite studimi. Kopetenca profesionale dhe vetëdija për profesionin thellohet në vitet e masterit pasi programi jep më shumë hapësira për pavarësi individuale dhe performancë individuale. Mbetet për tu parë sa procesi i thellimit do të ndodhë në disiplinat që kontribuojnë për tu aftësuar në mësimdhënje si mësues. Praktikat mësimore do ta identifikojnë kopetencën mësimdhënëse.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi në vlerësim, stimulon aftësitë e vecanta në disiplinat e Skenografisë e Kostumografisë, specifikisht aftësitë në komunikimin me gjuhën artistike, bashkëveprimin dhe konvergimin me fusha të tjera të artit dhe edukimit. Kjo u konstatua nga seanca mësimore që patëm rastin ti ndiqnim përgjatë vizitës në institucion si dhe nga bashke bisedat me studentët. Kurrikula liston kopetencat specifike për çdo disiplinë. {Shih-Evidencën 44}</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Aftësitë dhe kopetencat që ndërton studenti/ja gjenden të listura në dokumentin e kurrikulës në çdo syllabus. Por stafi akademik si dhe studenti/ja priren të përmbushin cilësisht ato deri në përfundim të syllabusit. Format e vlerësimit i bejnë të ditur studentëve se në çfarë niveli ata po shfaqin kopetencën që pritet prej tyre deri në detyrimet përmbyllëse. Kjo është e para parë në rregulloren e Programit.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë</p>	<p>Oret e punës në ateljere, seminarët, punët në grup, punët në projekte konsiderohen si mjediset akademike, artistike, mësimdhënëse, ku studentët ballafaqohen me atë çfarë ata kanë</p>

<p>studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>mbërritur ose nuk kanë mbërritur. Atë që dinë, dhe atë që presin ta mësojnë. Stafit akademik komenton, krahason performancën e çdo studenti/je në detyrat që ata duhet të përmbushin si dhe orientohen drejtë përmirësimit deri në nivel kopetencash profesionale. Klima në grup dhe bashkëbisedimi i orientuar drejtë përmbushjes së kopetencave janë të dukshme dhe të matshme. {Shih Evidencë – 74}</p> <p>Referuar evidencave shoqëruese të RVB-së, UART-i ka zhvilluar ndër vite marrëdhënie bashkëpunimi në fusha të ndryshme me interes të ndërsjellë të palëve, me institucione të ndryshme si brenda ashtu edhe jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar vendimit të KM nr. 329, datë 12.04. 2017, IAL, vlerëson dhe planifikon tratimin e vecantë dhe trajnimin e stafit akademik dhe mësimor që përmbush programin. Është në natyrën e vetë programit mësimor organizimi i shfaqjeve, premierave, shkëmbimeve kulturore, në bashkëpunim me personalitete të shquara të fushës apo me grupe dhe trupa teatrore apo televizive, brenda apo jashtë vendit. UART-i është pjesëmarrës dhe fitues i Projektit ADNICH, me Leader Partner, Teatrin “Zetski Dom” Cetinje, Mal i Zi, si dhe me partnerë italianë Universitetin e Salentos dhe Italian Theatre Institute Lecce si dhe Bashkinë Pogradec. Projekti ka zgjatur 24 muaj.</p> <p>{Shih Evidencë 87}</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Programi nxit mjaftueshëm studentët drejtë projektve në Kostumografi dhe Skenografi. Por nuk konstatoam të kishte mbështetje financiare nga institucioni.</p>

Konkluzione	<i>Standardi III.4 është i përmbushur. Programi ka bukur te listuara Oret e punës në ateljere, seminarët, punët në grup, punët në projekte konsiderohen si mjediset akademike, artistike, mësimdhënëse, ku studentët ballafaqohen me atë çfarë ata kanë mbërritur ose nuk kanë mbërritur, dhe riformulojnë objektiva te reja mesimore deri ne përmbushje te programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk është përmbushur	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>E konfirmojmë që Institucioni, krijon procedura për detyrimet përmbyllëse të studentit/es. Procedurat, kriteret i bën të njohura për studentët dhe i bën ato të dokumentuara dhe publike. Disa nga kriteret e detyrueshme janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. të ketë përmbushur detyrimet e planifikuara në planin mësimor conform disiplinës; 2. të ketë frekuentuar programin në masën që përcakton rregullorja e programit; 3. të ketë përmbushur praktikën mësimore dhe të disponojë dokumentin nga institucioni ku e ka përmbushur praktikën; 4. të jetë regjistruar në sekretarinë msimore brenda afatit kohor për datën e provimit; <i>[Shih Evidencë 2.2]</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Në IAL, struktura e informimit dhe këshillimit të studentëve si dhe Zyra e Sektorit Mësimor, asiston studentët veçmas gjatë sezonit përmbyllës si dhe në sezonin e diplomës. Kjo bëhet në dy mënyra kryesisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Këshillim online; b. kontakte të planifikuara direct të stafit akademik me studentët;

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Diploma merr pjesën më të ngarkuar për studentët. Në fillimin e vitit të dytë të studimeve Studentët njohen në mënyrë të detajuar rreth procesit të përbushjes së Diplomës. Dy janë momentet esenciale:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. pjesa e projektit artistic; b. pjesa teorike, didaktikisht shpjeguese, interpretuese e projektit artistic; <p>Çdo detaj i procedurës gjendet në faqen zyrtare të UËART.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Komisioni i posaçëm që administron dhe bën vlerësimin final të Studentit në Diplomë, lë hapësirë studentëve të demonstronjë projektin artistik, interpretojnë dhe analizojnë atë. Komisioni investigon formimin teorik të studentit, heton në kopetencat artistike që ai/ajo shpalos dhe i vlerëson ato në raport me kopetencat e planifikuara në kurrikul. Le hapësirë studentëve të arsyetojnë, interpretojnë e komentojnë performancën e tyre. Komisioni heton në kopetencat komunikuese e transmetuese të studentëve, referuar dhe kopetencave në fushwn e mësimdhënies.</p> <p><i>{Shih- Rregulloren e Departamentit të Skenografi Kostumografisë}</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë</p>	<p>Pedagogu që mer rolin udhëheqës të Diplomës, e fillon këtë detyrë që në fillim të semestrit të dytë. Bashkëpunimi me studentin/en nis për përcaktimin e projektit artistik apo të Diplomës teorike që mund të zgjellë studentin i sygjerruar nga pedagogu. Diploma është vendimarrje e studentit me miratim të Pedagogut. Kohën më speciale e merr formatimi dhe hapat për përbushjen e saj e përkthyer në kohë rreptësisht të përcaktuara. Studenti përfiton takime të vazhdueshme nga pedagogu në funksion të arritjes së objektivave enkas për diplomën. Pedagogu orienton studentin drejt metodologjisë dhe literaturës që i duhet në përbushje të diplomës. Kur Pedagogu dhe studentin ta konsiderojnë si të maturuar Diplomën, e deklarojnë atë të gatshme për të dalë para komisionit. Pedagogut i njihen orët në funksion të udhëheqjes së Diplomës së studentit. <i>{Shih Evidencë 2.3 dhe 2.4. Rregullore e FAS}</i></p>

për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Ky kriter nuk gjen hapsirë në UART, për arsye të natyrës specifike të studimeve që kryhen. {S&K} i mbështet studentët dhe i stimulon ata, referuar individualitetit të tyre artistik, si dhe referuar parapëlqimit të tyre për të selektuar projektin artistik ku ata ndihen të orientuar artistikisht. Institucioni i mbështet studentët me mjediset fizike specifike si, sallat e performimit artistik, literaturës specifike që mund të jete kujtesa skenike kostumografike e dixhitalizuar, i mbështet me rekujzitën ndër vite, sekuenca filmike. Stafi akademik i orjenton konkretisht studentët ku të mbështeten dhe si ta përtypin materialin Kostumografik dhe Skenografik për projektin artistic që student/ja ka për të përmbushur.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studenti/ja merr vlersimin përfundimtar me NOTE. Komisioni i Diplomës jep vlerësim individual me pikë për studentin/en. Pikët përkthehen në nota dhe del një notë përfundimtare rezultante e notave të komisionit. Nëse, studenti vlerësohet negativisht është i detyruar të ri-japë provimin përfundimtar. Gjithcka që lidhet me provimin final është i rregulluar në dokumentacionin ligjor institucional, si rregullorja e Programit.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Diploma me titull Skenografi, Kostumografi në Mësuesi është konceptuar dhe ka kaluar procedurat në agjensitë legale të konfirmimit. Diploma shoqërohet me suplementin respektiv si e drejtë e studentit për të zotëruar dhe përdorur diplomën në rast ekujvalentimi. {Shih- Kopje e Diplomës RVB}
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti	Në zyrën e sekretarisë cdo student i përfshirë në programin në fjalë, ishte përfshirë në program përmes procedurave administrative mbi një bazë ligjore. Student/ja kishin dosjen respektive të plotësuar me dokumentacion personal konform rregullores së institucionit. Kjo dosje mund të pasurohej me

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

informacione për studentin nëse kërkohen.	dokumente shtese që vërtetoin performancën e studentit nder vitet e shkollimit. Studenti/ja mund ta përdorte dosjen nëse i lipset për gjëra të caktuara. {Shih- rregullorja e Studentit}			
Konkluzione	Standardi III.5 është i përmbushur. Referuar struktures se programit krijon bindjen se studenti është i mbështetur dhe stimuluar nga programi ne te gjitha aspektete dhe ne te gjitha bashkepunimet e mundeshme deri ne Diplomimin perfundimtar. Per kete egzistojne procedura.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Plot përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	<p>I gjithë programi në fjalë është i garantuar referuar hapësirave fizike specifike, që ofron Institucioni. Ateljet ku zhvillohet mësimi sallat me kapacitet 200 dhe 600 vende ku performojnë projektete artistike në mbyllje të diplomave apo përgjatë vitit akademik e potencojnë cilësinë e Programit në fjalë. Sallat janë në pikëpamjen teknologjike të arrira. Biblioteka e Institucionit e konfirmojmë që ishte e pasur në tituj esenciale në fushat e artit, por dhe relativisht në tituj në shkencat e Edukimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që literatura në, shkencat e mësimdhënjes dhe didaktikës, të pasurohet qëllimshëm në perspektiven e afërt.</i></p> <p>Praktikat e studentëve në sistemin arsimor parauniversitar janë të garantuara dhe në rrafshin administrativ dhe përmes marrveshjeve të Institucionit.</p> <p><i>{Shih- Evidencë 2.14, Marrveshjet Institucionale, 3.3 Praktikat profesionale, 4.16, Lista e mjediseve fizike në UART}</i></p>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet,	Ky kriter nuk aplikohet në rastin konkret për shkak të profilit specifik që ka programi në fjalë. Kopetencat profesionale të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	studentëve ushtrohen në mjediset fizike specifike që ka IAL si mjediset e kostumografisë, Skenografise dhe trashegimisë së dixhitalizuar që ka FAS dhe UART.			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika mësimore është e ekuivalentuar në orë mësimi, dhe në ECTS, si dhe është e garantuar të ndiqet nga Pedagogu i cili është i identifikuar që në fillim të vitit akademik për studentin/en. Praktika mësimore është e sanksionuar në marrëveshjet e IAL me Institucionet arsimore në disa qytete si DAR Tiranë, Korçë, Lac si dhe Shkollat e mesme artistike me statusin e shkollave kombëtare. {Shih-Evidenca 3.1}			
Konkluzione	<i>Praktikat mesimore jane te strukturuar ne programin ne fjale. Studentet dhe stafi jane mjaftueshem te qarte per peshen e praktikës mesimore dhe asaj profesionale. Por Praktika ne shkolle, si mesues i ri ne fushat e artit ende nuk eshte provuar, pasi institucionet ku pritet te permbushen nuk jane vene ende ne prove.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Mbështetur sipas të dhënave të DVV dhe në Raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe në takimet që u realizuan në Institucion si dhe kërkesave të parashikuara në Ligjin 80/2015, VKM Nr. 29, datë 10.09.2018, VKM Nr. 329, datë 12.04.2017, VKM, Nr. 145, datë 10.03.2021 dhe Kodit të Punës, stafi akademik i angazhuar në Programin e Studimit Master i Arteve në Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi i përmbahet këtyre kërkesave. GVJ konstaton se stafi i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi përmbush kërkesat ligjore por edhe kërkesat akademike në ofrimin e lëndëve që mbulojnë.

Duke parë CV e tyre, aktivitetet e shumta artistike, pedagogët e angazhuar në mësimdhënien e lëndëve kryesore të këtij programi studimi, kanë edhe një karrierë të pasur artistike. Për vetë specifikën e FAS/UART si institucion i vetëm arsimor publik në fushën e artit skenik, pjesa kryesore e personelit akademik me kohë të plotë dhe një pjesë e atyre me kontratë janë Alumni të dalë nga po auditoret e FAS/UART. Po e njëjta gjë konstatohet edhe për personelin ndihmës akademik të Departamentit të S&K. Më poshtë janë të dhënat e stafit akademik efektiv dhe me kontratë/ me kohë të pjesshme për këtë program studimi.

Referuar tabelave 6.1, 6.2 dhe 6.3 në RVB, përbërja e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie për tre vite akademike është si më poshtë vijon:

Tituj/grada	2021 - 2022		2020 - 2021		2019- 2020	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	3	-	3	-	3	-
Prof.As.Dr	5	-	5	-	5	-
Dr/PhD	4	1	4	1	4	1
Msc	1	2	1	-	2	-


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

41

	Në total	13	3	13	1	14	1
	<p>Bazuar në të dhënat e mësipërme evidentohet plotësimi i kuadrit ligjor lidhur me nivelin profesional në procesin mësimdhënës në një program të ciklit të dytë.</p> <p>Për sa i përket ngarkesës mësimore në auditor rezulton se raporti PAK dhe PAE është si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për vitin akademik 2021-2022, është 13 PAE me 3 PAK (81%-19%); - për vitin akademik 2020-2021, është 13 PAE me 1 PAK (92%-8%); - për vitin akademik 2019-2020, është 14 PAE me 1 PAK (93%-7%); 						
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e paraqitura në fund të raportit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit objekt vlerësimi nga GVJ, Master i Arteve në “Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi”, mbulon ngarkesën e detyrueshme mësimore sipas kategorisë të cilës i përket, në përputhje me VKM Nr. 29, dt 10.09.2018.</p> <p>Në të dhënat tabelore janë paraqitur edhe ngarkesa e personelit akademik të brendshëm në Departamente të tjera të FAS por edhe në Departamente të tjera të fakulteteve të UART të cilat japin mësim edhe në këtë program studimi.</p> <p>Referuar ngarkesës së stafit akademik të programit të studimit 2021-2022 të paraqitur nga Institucioni, vërehet se ngarkesa në orë e personelit akademik efektiv është më e larta 210 orë dhe më e ulëta 30 orë. Ndërsa ngarkesa mësimore e personelit akademik me kontratë është 75 orë më e larta dhe 20 orë më e ulëta.</p> <p>{Evidencë 5.2 Pasqyrat e ngarkesave të personelit 2021-2022}</p> <p>{Evidencë 5.3..Formularët e realizimit të ngarkesave 2020 – 2021}</p>						
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në</p>	<p>GVJ gjatë takimeve që relaizoi në Institucion si me drejtuesit e Fakultetit dhe të Departamentit por ashtu edhe me stafin akademik, konstaton se një nga pikat e forta të këtij programi studimi, por edhe e të gjitha programeve që ofrohen në</p>						

<p>programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>fakultetin e artit skenik, është stabiliteti i stafit akademik dhe qëndrueshmëria tij. Jo vetëm për tre vitete akademike që shtrihet vlerësimi i këtij programi por edhe më herët, stafi akademik nuk ka patur lëvizje. Gjatë vizitës në Burimet njerëzore, GVJ pa kontratat e punës për një personel akademik efektiv dhe për një personel akademik me kontratë apo me kohë të pjesshme. Personeli akademik i angazhuar në Programin e Studimit Master i Arteve në Skenografi – Kosotumografi dhe Mësuesi i ka nënshkruar kontratat me UART sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kontratat ishin të rregullta. GVJ ju deklarua se Institucioni paguan rregullisht për stafin akademik sigurimet shëndetësore dhe shoqërore.</p> <p><i>(Evidencë 5.5 Kontratat e punës së stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme)</i></p> <p><i>(Evidencë 5.6 Listpagesat e detyrimeve të stafit akademik me kohë dhe kohë të pjesëshme)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ ju komunikua gjatë takimit e gjithë procedura e rekrutimit për personel akademik në këtë program studimi. Në takimin si me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit por edhe me Drejtuesen e Burimeve Njerëzore, GVJ u njoh me të gjitha hapat që ndiqen për përzgjedhjen e personelit akademik. Hapat po i rendisim si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nevoja për personel akademik për një lëndë të caktuar lind në department. Kjo është Njësia e cila merret drejtpërdrejtë me domosdoshmërinë për të mbuluar lëndën me staf akademik; - kërkesat specifike hartohen nga përgj Departamentit dhe i përcillen Dekanit; - Dekani njofton Burimet njerëzore, e cila harton kriteret e përgjithshme; - Kriteret specifike, kriteret e përgjithshme, shpallen nga Rektori i UART në dokumentin informues i cili publikohet në faqen ëeb si dhe në median e shkrur apo elektronike; - Pas dorëzimit të dosjeve të të interesuarve, Dekani ngre komisionin ad hoc për vlerësimin e dosjeve; - Kandidaturat e renditura sipas pikëve nga Komisioni i



	<p>vlerësimin të dosjeve i dëgohen Rektorit i cili shpall fituesin sipas renditjes;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rektori vendos miratimin përfundimtar për të lidhur kontratën e punës me kandidatin/kandidatët e përzgjedhur; <p><i>(Evidencë 5.7 Dosja e praktikës së punësimit në FAS/UART)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ ju komunikua se për realizimin e sukseshëm të programit të studimit dhe të lëndëve që përmban ky program, rol të rëndësishëm luajnë edhe njësitë ndihmëse si struktura mbështetëse të UART që ndihmojnë institucionin, njësitë kryesore dhe njësitë bazë në realizimin e veprimtarisë mësimdhënëse, artistike-kërkimore-shkencore dhe atë administrative. Mbështetur edhe në RVB por edhe gjatë bisedave dhe takimeve në institucion, Struktura administrative dhe ndihmës akademike në FAS përbëhet si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kryetar dege në Fakultet -Krye Sekretar -Sekretar i Kurikulës dhe Marrdhënie me Studentët -Laborant i Skenografisë -Specialist i Regji Filmi dhe TV -Laborant i Garderobës dhe Rekuzitës -Laborant dekori dhe -Punonjës Pastrimi <p>Kjo strukturë angazhohet në ndihmë të procesit mësimor nëpërmjet elementeve të tillë si zhvillimi i punëve të laboratorit në përputhje me programin e studimit, ndjekja e zhvillimit të praktikave mësimore, mirëmbajtja e bazës laboratorike, ndihmesa në zhvillimin e praktikave të diplomave etj.</p> <p><i>(Evidenca 5.8 Lista e stafit ndihmës akademik RRFTV)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të</p>	<p>Bazuar në DVV dhe nga ajo që u komunikua gjat vizitës në institucion, të gjitha të dhënat e personelit akademik që lidhen me kualifikimin e tyre, aktivitetin artistik, aktivitetin shkencor mbahen në dosjen personale të tyre të cilat administrohen nga Burimet Njerëzore. GVJ ju komunikua se dosja e stafit</p>

<p>dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>akademik është objekt përditësimi të përvitshëm dhe përmban të gjitha të dhënat e stafit akademik, ku stafi akademik udhëzohet që të përditësojë vazhdimisht CV e tyre, pasi aktivitetet e tyre artistike ndryshojnë dhe janë gjithmonë në rritje. Veprimtaritë e sipërpërmendura shoqërohen me dokumentacion vërtetues. (Evidencë 5.1 VKM Nr. 329, datë 12.04.2017) (Evidencë 5.9 Realizimi I Marrëveshjeve vjetore S&K) (Evidencë 1.1 Udhëzimi Nr.29, datë 10.09.2018)</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas dosjes së DVV, si dhe gjatë komunikimeve në Institucion sidomos me stafin akademik dhe me Dekanatin e FAS, GVJ ju komunikua se Studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në “Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi”, duhet të realizojnë praktikat mësimore pranë një institucioni të arsimit parauniversitar, në përputhje me parashikimet e planit mësimor dhe në mbështetje të lëndëve specifike të mësuesisë. Departamenti i S&K/FAS nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me institucionin pranë të cilit do të zhvillohet praktika ose me institucionin qëndror. Në rastet e nënshkrimit të marrëveshjes me institucionin qëndror, veç të tjerash, parashikohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkolla/t pranë të cilave do të kryhet praktika mësimore; - Numri i studentëve për çdo shkollë. <p>Në vazhdimësi Departamenti i S&K/FAS, përcakton një ose disa pedagogë, në varësi të numrit të studentëve për të ndjekur praktikën dhe për të mbajtur kontakt me institucionin pritës. (Evidencë 3.3 Dosja e Praktikës Profesionale)</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë</p>	<p>Sic e kemi thënë edhe në kriterin më sipër, për realizimin e praktikave profesionale, FAS angazhon një pedagog i cili mbikqyr zhvillimin e praktikës. Përfaqësuesi i institucionit pritës mbikqyr dhe ndihmon studentin gjatë zhvillimit të praktikës, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar. Në përfundim të praktikës, përfaqësuesi i institucionit pritës, jep vlerësimin e tij për çdo student të mbikqyrtur. (Evidencë 3.3 Dosja e Praktikës Profesionale)</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.									
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit MA në "Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi"</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>GVJ gjatë vizitës në Institucion pa se Infrastruktura e UART është e përshtatshme për përmbushjen e nevojave të mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike, kërkimore – shkencore. Në dispozicion të programit të studimit janë vënë mjedise me përmasa të mjaftueshme. Këto ambiente janë optimale dhe në përputhje me natyrën specifike të programit.</p> <p>Atelieri i skenografisë dhe kostumografisë është në funksion të programit së bashku me ambientet e laboratorëve të tij. Në dispozicion të zhvillimit të orëve mësimore janë edhe sallat e performancave Black-Box, me dy mjedise përkatësisht 40 dhe 200 vende spektatorësh dhe me hapësira të bollshme skenike.</p> <p>Sipas dosjes se DVV, FAS gjendet në godinën D të UART, në një ndërtesë e cila është përfunduar në vitin 1972. Sipërfaqja totale e objektit është 1066 m²; nga të cilat 534 m² janë Sipërfaqe ambiente mësimi; 138 m² janë Sipërfaqe në funksion të zyrave; 47 m² janë sipërfaqe të ambienteve ndihmëse për mësim dhe 347 m² janë Sipërfaqe ambiente shërbimi&komunikimi.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<i>(Evidenca 5.10 Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Sipas dosjes se DVV dhe asaj që u vizitua fizikisht, një nga sallat në funksion të aktiviteteve artistike por edhe të shfaqeve në funksion të programit MA në Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi është edhe Salla "Black-Box", sallë e cila sipas dokumentacionit të paraqitur në DVV ndodhet në Godinën B të UART. Salla "Black Box" ka një total prej 570 m ² , nga të cilat 302 m ² është salla e madhe e shfaqeve, 98 m ² është salla e vogël e shfaqeve, 21 m ² është ambienti teknik dhe 5 m ² është ambienti i komandimit. Pjesa tjetër janë ambiente shërbimi dhe tualete. Po në këtë ndërtesë janë edhe 132 m ² të studiove në funksion të FAS. Një pjesë e auditorëve ku realizohet ngarkesa mësimore për Programin e Studimit Master i Arteve në "Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi" janë të pajisura me aparaturat e teknologjisë së informacionit, të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. <i>(Evidencë 5.11 Lista e pajisjeve në shërbim të RRFTV)</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ mbështetur në RVB deklaron se, studiot dhe laboratorët e FAS/UART janë të pajisura me aparaturat e nevojshme për realizimin e Programit të Studimit Master i Arteve në "Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi". GVJ gjatë vizitës pa mjediset mësimore, zyrat, klasat, atelienë, sallat e performancës, të cilat ishin të pajisura me mjetet e nevojshme për plotësimin e realizimit të lëndëve në funksion të këtij programi. <i>(Evidencë 5.11 Lista e pajisjeve në shërbim të S&K)</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas	Gjatë takimit dhe vizitës GVJ ju komunikua se Departamenti i S&K zotëron në ambjentet e tij laboratorë të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale. Por për vetë specifikën e programit, ofrimi i laboratorëve të teknologjisë së informacionit nuk është kusht i domosdoshëm, pasi vetë studio dhe klasat mësimore janë laboratorë të mirëfilltë në lëndët e tjera profesionale dhe në të gjithë aktivitetet e tjera, ku përfshihet si

natyrës së programit të studimit që ofron.	bazë e lëndës dhe ndërveprimi fizik midis studentëve të këtij programi studimi dhe klasat përkatëse luajnë rolin edhe të laboratorëve, por në këtë rast jo të pajisjeve dhe mjeteve elektronike dhe teknologjisë, këto pajisje ndihmojnë pjesërisht në realizimin e qëllimeve dhe objektivave të programit në fjalë.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	Ashtu siç është e paraqitur edhe në RVB, por mbështetur edhe në rregulloren e programit të studimit, GVJ shprehet se praktikat e zhvilluara në programin e studimit nuk janë praktika të mirëfillta profesionale. Praktikat që ofrohen dhe parashikohen në planin mësimor të programit janë praktika profesionale artistike dhe praktika mësimore. Praktikat profesionale artistike, në përputhje me specifikën e programit të studimit, materializohet në përfitim të përvojave kryesisht skenike dhe artistike sipas programit për çdo vit studimi. Këto praktika zhvillohen, sipas specifikës, osë në ambientet e institucionit, ose në institucionet partnere të UART. Në planin mësimor të Programit të Studimit Master i Arteve në "Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi" është parashikuar të zhvillohet vetëm praktika mësimore. Kjo praktikë mësimore zhvillohet në marrëveshje me DAR dhe pranë institucioneve të arsimit parauniversitar. (Evidencë 3.3 Dosja e Praktikës Profesionale)			
Konkluzione	GVJ konstaton se Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën për realizimin e procesit të mësimdhënies të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë kqyrjes së syllabuseve të lëndëve të parashikuar në planin mësimor të porgramit të studimit, vërehet se Literatura bazë dhe ndihmëse plotëson të gjitha kriteret e vlefshmërisë dhe përdorimit. Gjatë vizitës në institucion konstatoam se, literatura e për realizimin e këtij program studimi përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Literatura bazë; - Literatura ndihmëse; - Periodik të huaj; - Periodik shqiptare; - Enciklopedi, diksionerefjalor; - Koleksione periodike në fushat e artit; - Punime teorike universitare dhe pasuniversitare të studentëve dhe pedagogëve etj. <p><i>(Evidencë 3.2 Kurrikula e Programit të Studimit Master)</i> <i>(Evidencë 5.12 Lisat e literaturës RRFTV në Bibliotekën e UART)</i> <i>(Evidencë 5.13 Linku i leksioneve të Teknikave të Produksionit skenik)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Bibliotekën e UART, u informua se vazhdimisht kjo Bibliotekë mban kontakte me Përgjegjësat e Departamenteve për përditësimin e literaturës së programeve të studimit që ofrojnë në Departamentet e tyre. Departamenti i Skenografisë, për natyrën e tij specifike e ka pak më të reduktuar përditësimin e literaturës pasi, ashtu siç është paraqitur edhe në RVB, ka mungesë të një tregu për botime artistike/pedagogjike në gjuhën shqipe. Kjo literaturë është kushtëzuar të jetë në gjuhët kryesore evropiane, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. <i>(Evidencë 5.12 Lista e literaturës RRFTV në Bibliotekën e UART)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve</p>	<p>Në funksion të studentëve që ndjekin këtë program studimi por edhe të gjithë studentëve të programeve që ofrohen në UART</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>është edhe Biblioteka e UART. Gjatë vizitës në Bibliotekën e UART, GVJ ju sqarua dhe ju komunikua se Biblioteka e Universitetit të Arteve ka në përbërje të saj dy salla (laboratorë) në shërbim të studentëve, salla e Fondit të Hapur dhe salla “Media Library”.</p> <p>Ashtu siç është paraqitur edhe në RVB, GVJ konfirmon se: në këto salla mund të punohet me editim jo-linear audio, montazh fotografik, dizajn grafik, dizajn 3 dimensional, editim jo-linear video/ montazh filmik, dizajn inxhinierik, procese office, punë kërkimore shkencore, etj. Në këto salla aksesohen burimet elektronike të vetë Bibliotekës së Arteve, si dhe burime të shumta elektronike online, të cilat i janë mundësuar UART.</p> <p><i>(Evidencë 5.14 Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale)</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ ju komunikua se shërbimet elektronike të Bibliotekës së Universitetit ofrohen për anëtarët e saj përmes dy sistemeve, të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. sistemi i menaxhimit të integruar përmes të cilit Biblioteka kryen katalogimin dhe administrimin elektronik të fondit fizik të titujve të disponuar, kartelave elektronike, qarkullimin, etj., si edhe kryen shfaqjen përmes shfletuesit publik (OPAC) të titujve për audiencën e gjerë; 2. sistemi i arkivit digjital përmes të cilit përdoruesit kanë mundësi të shfletojnë materialet në trajtën elektronike (digjitale); <p>Biblioteka e UART i ofron koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet ambienteve si salla me fond të hapur (sallë e cila i jep mundësinë përdoruesve të bibliotekës të shfrytëzojnë pa limit librin që dëshirojnë dhe duke fotokopjuar atë cka studentët dëshirojnë) dhe fondi i mbyllur (literaturë e arstit dramatik si teori drame; punime teorike; përkthime; drama; tregime; romane, etj)</p> <p>Disa prej titujve apo literaturës që gjendet në Bibliotekë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fondi referues – enciklopedi, diksionere, tituj 150 +100 fjalor • Letersia shqipe - 3040 tituj • Letersia e huaj – 2646 tituj
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UART i ofron koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet ambienteve si salla me fond të hapur (sallë e cila i jep mundësinë përdoruesve të bibliotekës të shfrytëzojnë pa limit librin që dëshirojnë dhe duke fotokopjuar atë cka studentët dëshirojnë) dhe fondi i mbyllur (literaturë e arstit dramatik si teori drame; punime teorike; përkthime; drama; tregime; romane, etj)</p> <p>Disa prej titujve apo literaturës që gjendet në Bibliotekë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fondi referues – enciklopedi, diksionere, tituj 150 +100 fjalor • Letersia shqipe - 3040 tituj • Letersia e huaj – 2646 tituj

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



E-mail: info@ascal.al

	<ul style="list-style-type: none"> • Drama, perkthime teorike, ne shaptilograf, printime - 1000 tituj • Estetika, filozofi, psikologji, sociologji – 200 tituj • Seriale – 1455 tituj <p>Arkiva digjitale e aksesueshme e kësaj salle është krijuar nëpërmjet shfrytëzimit të sistemeve me bazë "kod me burim të hapur". Qëllimi i kësaj arkive është që të ofrojë akses të brendshëm, kombëtar dhe ndërkombëtar për të gjithë audiencën e Bibliotekës së UART.</p> <p><i>(Evidencë 5.15 Lista gjithëpërfshirëse e titujve fizikë në bibliotekën e UART)</i></p> <p><i>(Evidencë 5.14 Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale)</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ konformon se Biblioteka e UART, është e pajisur me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje kompjuterike. Në ambientet e bibliotekës ndodhet "Salla Multimediale" e cila është e pajisur me 20 kompjutera me qasje në internet të pajisur me software specifike. Në këto salla mund të punohet me editim jo-linear audio, montazh fotografik, dizajn grafik, dizajn 3 dimensional, editim jo-linear video/ montazh filmik, dizajn inxhinierik, procese office, punë kërkimore shkencore, etj.</p> <p><i>(Evidenca 5.16 Lista e pajisjeve të Bibliotekës së UART)</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e UART funksionon bazuar në përcaktimet e Statutit të UART Neni 21 dhe rregullores së bibliotekës. Në përputhje me sa më sipër, biblioteka qëndron e hapur duke nisur prej orës 08:00, orë në të cilën nis edhe procesi mësimor, e në vazhdim. Përgjatë sezonit të porvimeve, Biblioteka ofrohet edhe me orare të zgjatura.</p> <p><i>(Evidencë 5.17 Rregullorja e funksionimit të bibliotekës UART)</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt</p>	<p>Biblioteka bën përditësime periodike për shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit nëpërmjet Arkivës Dixhitale të BSHUA, nga ku rezulton se, për vitin akademik 2021-2022 kanë shfrytëzuar fondit online të bibliotekës 1073 përdorues, nga të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al



<p>kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>cilët 704 nga Shqipëria, 148 nga Kosova, 46 nga USA, 26 nga Italia etj.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Programi i studimit përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjëherë</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e</p>	<p>Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në FAS garantohet nga Rregulloret përkatëse, mbi të gjitha nga Rregullorja e Sekretarisë mësimore. UART gjithashtu siguron menaxhimin e informacionit dhe të dhënave për studentët dhe stafin akademik edhe nëpërmjet web-it (www.uart.edu.al/).</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al






<p>tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen edhe në format letër të Rregjistrimit themeltar, Rregjistrimit të arritjeve akademike, Rregjistrimit të kursit dhe Rregjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Për tu regjistruar në Programin e studimit Masteri i Arteve në Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi, student dorëzon dosjen me të dhënat personale dhe CV.</p> <p>Për menaxhimin e informatizuar të informacionit në FAS përdoret sistemi Pitagora, i cili është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretariteti) dhe ai akademik i FAS, nëpërmjet një Username-i dhe Fjalëkalimi.</p> <p><i>(Evidencë RVB; Vizita në institucion)</i></p> <p><i>(Evidencë Rregullore Institucionale; Rregullore e Sekretarisë Mësimore)</i></p> <p><i>(Evidencë 4.11 Screenshot (foto) nga sistemi Pitagora)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i informacionit synon të kontribojnë në menaxhimin si duhet të institucionit. Sistemi Pitagora është një sistem i ri, i cili është vënë në funksion në këtë vit akademik. Para këtij Sistemi, UART ishte një nga Institucionet e para e cila përqafoi sistemin elektronik ESSE 3. Edhe pse sistemi i përdorshëm tani, ai Pitagora është në përmirësim të vazhdueshëm dhe GVJ është i mendimit se ky sistem shërben për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit si dhe është detyrim i stafit akademik që në përfundim të çdo viti akademik të përditësoj dosjen e tij fizike pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.</p> <p><i>(Evidencë 1.15 Udhëzimi Nr.29 datë 10.09.2018)</i></p> <p><i>(Evidencë 5.9 Realizimi i Marrëveshjeve vjetore S&K)</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Akresi në sistemin Pitagora mundësohet nëpërmjet sekretarisë mësimore, e cila ka një hyrje dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Me anë të këtij sistemi i mundësohet sekretarive mësimore të hedhin online rezultatet e provimeve për studentët, të ndarë sipas grupeve dhe programeve përkatëse. Nëpërmjet web-it (www.uart.edu.al/) bëhet sigurimi i informacionit dhe dokumentacioneve të nevojshme për studentët dhe stafin akademik.</p> <p><i>(Evidencë 5.22 Manuali Pitagora)</i></p> <p><i>(Evidencë Vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ ju komunikua se Sistemi i integruar PITAGORA funksionin që prej një viti në UART. Nëpërmjet këtij sistemi vlerësimi i pedagogut për studentin në një lëndë specifike, pasqyrohet në kohë reale në adresën personale të studentit brenda të njëjtit sistem.</p> <p>Ky sistem siguron një sërë të dhënash si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njoftimin rreth datave të provimeve, vlerësimit të marrë dhe librezën e notave; - Shkarkimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të konsiderohen të nevojshme për studentët; - Njoftimin në kohë reale të notave apo mënyrave të tjera të vlerësimit të studentëve. <p><i>(Evidencë 5.22 Manuali Pitagora)</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Referuar RVB, sistemi i menaxhimit në FAS, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe u mundëson studentëve informacion mbi vlerësimet, mungesat, provimet etj. Ndërkaq sistemi prodhon edhe raportime individuale ose të përgjithshme me të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Realizimi i veprimtarisë akademike dhe artistike/shkencore të personelit akademik verifikohet në përputhje me Rregulloren e FAS.</p> <p><i>(Evidencë RVB)</i></p> <p><i>(Evidencë 5.23 Fletëprezenca të pedagogëve në orën e mësimi)</i></p>

<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja web (www.uart.edu.al/) e UART ofron një informacion të zgjeruar mbi institucionin në përgjithësi si dhe programin e studimit Master i Arteve në “Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi”. Në faqen web mund të merret informacion i zgjeruar për stafin akademik, informacion mbi kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfitim të bursave të studimit dhe çdo lloj informacioni tjetër, që ka të bëjë me aktivitetet e përditshme të Intitucionit. Një seksion i veçantë i kushtohet studentëve, ku gjenden informacione për aktivitetet e tyre të përditshme. Faqja web mund të aksesohet nga çdo përdorues.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UART disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



<p>Standardi IV.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Hartimi i Projekt Buxhetit afatmesëm dhe buxhetit të përvitshëm, përpos planifikimit të fondit të pagave për stafin akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar, bazohet në kërkesat e Njësisë Bazë S&K. Njësia bazë S&K dhe FAS nuk kanë drejtori ekonomike Brenda njësisë kryesore dhe për hartimin e projektbuxhetit bashkëpunohet me drejtorinë ekonomike në nivel universiteti. Planifikimi financiar nis cdo fillim vit kalendarik bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010. Konformojmë atë çka na u tha gjatë vizitës në insitucion dhe që është e paraqitur edhe në RVB se: Në kërkesat e paraqitura në funksion të mbështetjes financiare të programeve të studimit në varësi të saj, Njësia Bazë S&K përqëndrohet në:</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Parashikimin e stafit akademik më kohë të plotë; 2. Sigurimin e bazës materiale; 3. Parashikimin e mbështetjes së veprimtarisë artistike dhe kërkimit shkencor. <p><i>(Evidencë 5.28 Vendimi i Bordit të Administrimit për buxhetin)</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet</p>	<p>GVJ ju komunikua se në hartimin e projektbuxhetit dhe mbështetjen efektive financiare të programit të studimit merren parasysh kërkesat e paraqitura nga Njësia Bazë -S&K përgjegjëse për Programin e Studimit Master i Arteve në “Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi. Departamenti paraqet kërkesën për stafin akademik me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesshme. Financimi i stafit akademik me kohë të plotë sigurohet nga buxheti i shtetit ndërkohë që stafi akademik me kohë të pjesshme mbulohet financiarisht nga të ardhurat e vetë institucionit. Bazuar në planifikimin financiar, sigurohet mbështetje financiare për të gjitha shpenzimet e tjera që lidhen me programin e studimit.</p> <p><i>(Evidencë 5.26 paraqitja e buxhetit nga administrator i FAS)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Pavarësisht që UART raporton në mënyrë periodike në MASR pasqyrat vjetore financiare, GVJ deklaroi se UART, për periudhën në të cilën shtrihet edhe vlerësimi i programit në kuadër të akreditimit, nuk i është nënshtruar ndonjë auditimi financiar.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ ju komunikua se Drejtoria Ekonomike e UART paraqet çdo vit analizën për veprimtarinë ekonomike të institucionit. Në këtë analizë vjetore zënë vend raportimi mbi realizimet e zërave sipas parashikimeve të bëra në projekt buxhet dhe realizimeve konkrete të tyre, si: investimet, fondin e pagave, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, mallrat dhe shërbimet e tjera, transferimet korrente për jashtë, ndihmë për individët dhe bursa. Çdo zë paraqitet me peshën specifike në buxhetin total të vitit. Çdo raport financiar kalon për miratim në Senatën Akademik të UART sipas parashikimeve të ligjit.</p> <p><i>(Evidenca 5.31 Dokumente nga drejtoria ekonomike mbi raportimin për realizimin e buxhetit)</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ ju komunikua se institucioni nuk ka pasur nevojë të ndërhyjë në përmirësimin e situatës financiare. Departamentet nxiten të marrin pjesë në aplikime të ndryshme të projekteve të cilat do të ndikonin në përmirësimin e situatës financiare të fakultetit në përgjithësi.</p> <p><i>(Evidencë 3.17 Model aplikimi projekti)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p> <p>GVJ u interesua pse UART nuk zhvillon auditim dhe përgjigja ishte se , UART nuk plotëson kushtet për të patur një Strukturë të Auditimit të brendshëm, mbështetur në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në Sektorin publik”, pika 1, b. - <i>Njësitë e auditimit krijohen në çdo institucion tjetër që kryen funksione publike, shoqëri tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, si dhe njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike sipas një marrëveshje ndërkombëtare, të cilat kanë në vit, njëkohësisht jo më pak se 400.000.000 (katërqind milionë) lekë të ardhura financiare dhe 300 punonjës, përgjatë 3 (tri) viteve të fundit të veprimtarisë së tyre, me përjashtim të rasteve kur ngritja e njësisë së auditimit të brendshëm parashikohet nga një ligj i veçant.</i> Megjithatë UART raporton në mënyrë periodike në MASR pasqyrat vjetore financiare.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se UART ka të hartuara një sërë dokumentash rregullativë që mbulojnë studentët që në hyrje e tyre dhe deri në dalje. Gjithashtu ky institucion zbaton politika dhe procedura mbi të cilat mbështetet cikli i plotë i programit të studimit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Statuti i UART -Rregullorja e Institucionit -Rregullorja e Fakultetit të Artit Skenik -Rregullorja e Departamentit të S&K -Rregullorja e Ciklit të Dytë të studimeve -Rregullorja e programit të Studimit Master i Arteve në "Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi" -Rregullorja e Sekretarisë mësimore <p>Konstatojmë se Rregulloret e mësipërme janë të mbështeturra në Ligjin e Arimit të Lartë dhe Akteve nënligjore në fuqi si dhe janë të miratuara me Vendim të Senatit Akademik.</p> <p>Gjithashtu ky institucion gëzon Statusin e veçantë që në muajin mars të vitit 2021 sipas VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, "Për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p><i>dhënien e Statusit të veçantë UART si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.</i></p> <p>Të gjitha aktet rregullative janë miratuar me Vendim të Senatit Akademik dhe janë lehtësisht të aksesueshme në web faqen (www.uart.edu.al.)</p> <p>(Evidencë 1.6 Ligji për arsimin e lartë 80/2015)</p> <p>(Evidencë 1.15 Statusi i UART)</p> <p>(Evidencë 2.7 Rregullorja e UART)</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ashtu siç edhe është shprehur edhe në RVB, Fakulteti i Artit Skenik, ashtu si edhe i gjithë UART, ka në vizionin e tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës si dhe të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik-shkencor; - të formojë specialistë të lartë të fushave të arteve dhe të përgatisë artistë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; - të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; - të kontribuojë në zhvillimin artistik, ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal; - të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; - të integrojë mësimdhënien me kërkimin artistik-shkencor; - të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë dhe më gjerë; - të nxisë formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës; - të nxisë thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës; - të ofrojë mundësi për kryerjen e studimeve artistike-kërkimore-shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën; <p>Të gjitha kriteret, procedurat apo ndonjë kërkesë mund të ketë qasje në web faqen zyrtare të UART, si dhe nëpërmjett zyrave</p>

	përkatse të institucionit.
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ në disa drejtime Ju komunikua se pranimet e studentëve në FAS, ashtu si edhe në të gjitha programet që ofrohen në UART zhvillohen me Konkurs.</p> <p>Kriteret e pranimit për ciklin e dytë të studimeve, pjesë e të cilit është edhe programi jonë, objekt vlerësimi, MA në “Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi”, pasi miratohen në Senatin Akademik bëhen publike. Studenti i interesuar mund ta marri këtë informacion si në web faqen e UART, ashtu edhe në Sekretarinë mësimore të Fakultetit, por edhe nga përgjigjet që jep Sektori mësimor nëpërmjet email, ose në rrjetet sociale si Facebook, Instagram. Në Rregulloren e FAS, neni 11, janë paraqitur gjerësisht kriteret për rregjistrimin e studentëve</p> <p><i>(Evidencë Rregullorja e FAS, neni 11)</i></p> <p><i>(Evidencë 4.8 VSA Nr.35 datë 7.12.2021)</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, kriteret, procedurat e pranimit, të transferimit të studimeve, si dhe kriteret e diplomimit janë të përcaktuara qartë në këtë Rregullore. Kjo rregullore është e miratuar me VSA Nr 37, datë 20.07.2022.</p> <p>Të gjitha janë të shtjelluara sipas neneve dhe konkretisht:</p> <p>Pranimi i studentëve, neni 11</p> <p>Rregjistrimi i studentëve, neni 12</p> <p>Transferimi i studentëve, Kreu IV, neni 25</p> <p>Diplomimi i studentëve, Kreu VIII, neni 31</p> <p><i>(Evidencë 2.5 Rregullorja e programit të studimit MA në “Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi”)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të</p>	<p>GVJ ju komunikua se në mbështetje të informimit të publikut si dhe kandidatëve të mundshëm, institucioni organizon përpara fillimit të çdo viti akademik, takime të hapura të stafit akademik me kandidatët e interesuar për të ndjekur programet Master, duke u shpjeguar kriteret, procedurat, tarifat dhe mundësitë e regjistrimit në programet që të interesuarit shfaqin interes, mundësitë e mobiliteteve etj.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

<p>veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, UART në përgjithësi por FAS në veçanti si Njësia kryesore e ofrimit të këtij programi studimi informon të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme të programit të studimit, të cilat bëhen publike në:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) në web faqe të Fakultetit b) në ambientet e dukshme të FAS. <p><i>(Evidencë 2.5 Rregullorja e programit të studimit MA, neni 11)</i> <i>(Evidencë 3.8.... VSA për miratimin e kriterëve të pranimit)</i> <i>(Evidencë 6.1 Urdhër i Dekanit FAS për komisionet e pranimeve 2021 – 2022)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Në takimin e fundit GVJ ju komunika se në S&K / FAS nuk parashikohen kuota për studentët me aftësi të kufizuara. Konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit për programet e studimit që UART ofron, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online.</p> <p>Për studentët që vijnë nga shtresa sociale “Romë / Ballkano - Egjiptiane”, FAS / UART ndjek politikë mbështetëse për këtë kategori, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në zbatim të këtyre akteve parashikohen kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik.</p> <p><i>(Evidencë.3.9 VKM për përjashtimin e nga pagesa të studentëve; Romë/Ballkano –Egjiptianë.)</i> <i>(Evidencë 3.10 kapacitetet pritëse të S&K/FAS)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Rezulton se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi. (http://ëëë.uart.edu.al/)</p> <p>Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UART, gjenden në çdo kohë Rregulloret dhe Kriteret për pranimin e studentëve si vendas ashtu edhe të studentëve të huaj. Në kapacitetet pritëse që hartohen çdo vit nga Fakultetit për të gjitha programet që ofron, një vend i veçantë i dedikohet edhe kuotave për shtetas të huaj. Në nenin 12 të rregullores së Programit të Studimit Master i Arteve në Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	shkruhet shprehimisht "Studentët e huaj duhet të dorëzojnë dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe". <i>(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master, neni 11 dhe 12)</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UART në përgjithësi dhe FAS në veçanti, kanë hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë të komunitetit Romë, Ballkano dhe Egjiptianë si dhe jep bursa për shtresat në nevojë dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke i publikuar ato në faqen e internetit: http://uart.edu.al/index.php?id=1138			
Konkluzione	GVJ konstaton se FAS si dhe Departamenti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit MA në "Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi", ka hartuar politika dhe procedura për pranimin e studentëve duke i ndjekur me rigorozitet dhe duke i zbatuar ato.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyset	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konfirmon se kriteret dhe procedurat e kalimit të studentëve nga njëri vit akademik në tjetrin janë të bazuara dhe rregulluara sipas Rregullores së programit të studimit MA në "Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi". Në këtë Rregullore janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrat e studentëve, zhvillimi i provimeve, e drejta për të hyrë në provim, kriteret dhe procedura të vlerësimit, dokumentimi i vlerësimeve, komunikimi i vlerësimeve, transferimi i studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve, etj.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>Gjithashtu GVJ ju bë e ditur se përmes sekretarisë mësimore, ëeb faqes së UART (www.uart.edu.al) dhe sistemit PITAGORA, jepet informacion lidhur me të gjithë procesin dhe përparimin akademik të studentëve. Studentët informohen në detaje lidhur me vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë gjithë vitit akademik; për numrin e krediteve të akumuluar; për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin, etj.</p> <p><i>(Evidencë 2.3 Rregullorja FAS)</i> <i>(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Mbështetur në Rregulloren e programit të studimit, kriter bazë për pranimin në studimet e këtij programi studimi, MA në “Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi”, është studimi i plotë i programit Bachelor në S&K, si dhe kriteret e tjera që përcaktohen qartë në rregulloren e UART. Kriteri kryesor është konkursi dhe pranimi në këtë program studimi.</p> <p><i>(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Sekretaria mësimore e Fakultetit të Artit Skenik i informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. GVJ ju komunikua se në FAS, mësimdhënia është e organizuar në mënyrë individuale për lëndët speciale dhe në grupe të vogla dhe të mëdha për lëndët artistike/lëndët e formimit bazë. Gjatë takimit me studentët, GVJ ju tha se për gjithçka që ka të bëjë me procesin mësimor, studentët informohen në mënyrë të detajuar nga pedagogët e lëndës.</p> <p><i>(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master, neni 22)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e diplomimit në programin e studimit Master i Arteve në “Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi”. Sipas Rregullores së Programit të Studimit Master, në planin mësimor kriteret dhe procedurat e realizimit të temës së diplomës, dhe diplomimit janë të rregulluara qartë dhe u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet Departamentit të S&K, në mënyrë të vazhdueshme, duke ju dhënë informacione të detajuara lidhur me përgatitjen dhe procesin e diplomimit. Gjithashtu studentëve ju jepej</p>

	<p>informacion për përmbushjen e kriterëve për diplomimin, caktimin e pedagogut udhëheqës si dhe për politikat e plagjaturës.</p> <p><i>(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ ju sqarua mënyra se si funksiononte UART në përgjithësi, FAS dhe Departamenti i S&K në veçanti për mënyrën sesi ky institucion mundohet të tërheqë sa më shumë kandidatë për studentë në programet që ofron. UART ka ngritur struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj. Faqja zyrtare www.uart.edu.al, panairët e organizuara nga MAS, si dhe faqja më e re e informimit matura shtetërore, në portalin U-Albania të administruar nga Zyra e Sektorit mësimor në bashkëpunim me TI dhe informimit, japin informacionin e duhur ku në kohë reale kandidatët pyesin dhe marrin përgjigje për secilën problematikë të ngritur prej tyre.</p> <p>Për një informacion edhe më të madh përdoren edhe rrjetet sociale <i>Facebook, Instagram, LinkedIn, Google+ dhe Youtube</i>, ku një pjesë e studentëve kanë një llogari aktive në këto platforma. Në UART synohet përveç kandidatëve të huaj synohet edhe informimi i nxënësve të shkollave të mesme, për të nxitur që të mund të ndjekin talentin e tyre në fushën e përzgjedhur.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ shprehet se UART në përgjithësi dhe FAS dhe Departamenti i S&K në veçanti, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit të tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës në dispozicion të tyre.</p> <p>Informacioni në lidhje me këta elementë shpërndahet edhe përmes sekretarisë mësimore e cila luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve, notat etj. Programet e publikuara në faqen zyrtare gjenden sipas kategorive psh.: Fakulteti i Artit Skenik, Programet e studimit: Departamenti i S&K, ku për secilin program, sipas departamenteve janë hedhur të dhënat kryesore, në të cilat gjendet edhe programi i planit mësimor si:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Viti akademik -Semestrat -Kohëzgjatja e programit -Lëndët sipas kategorisë -Orët mësimore në auditor -Forma e kontrollit -Kreditë për lëndët <p><i>(Evidencë Takime në institucion)</i> <i>(Evidencë Takim në Sekretarinë Mësimore).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstatoi se një burim i rëndësishëm informacioni për studentët përveç informimit të tyre nga pedagogu i lëndës në lidhje me modulet, lëndët, veprimtaritë formuese të programit, etj janë të publikuara edhe në ëeb faqen e UART www.uart.edu.al.</p> <p>Nëpërmjet kësaj ëeb faqeje studentët mund të kenë aksesë dhe të marrin gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit. E gjithë baza rregullative e UART është e printuar në</p>

	<p>formatin fizik <i>hard copy</i> për përdorim të përgjithshëm dhe gjenden në Bibliotekën e UART dhe pranë departamenteve.</p> <p>Për komunikimin në kuadër të realizimit të procesit mësimor për programin e studimit përdoret edhe Sistemi Pitagora, sistem i cili është bërë i mundur të aplikohet nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) për të gjithë Institucionet e Arsimit të Lartë publik që kanë dashur të jenë pjesë e këtij Sistemi.</p> <p><i>(Evidencë Takime në institucion; RVB)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Referuar RVB, programet dhe riorganizimi i tyre, janë të përshtatshme për t'iu përgjigjur tregut të punës. Këtij qëllimi i ka shërbyer Urdhëri i MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 dhe Nr. 512, datë 24.10.2019. si dhe zbatimi i Udhëzimit të MASR Nr.52, dt.03.12.2015, i ndryshuar për gjuhët e huaja. Realizimi i programeve mësimore mbështetet në metodat që vënë theksin tek student, si dhe që kërkojnë formimin e njohurive hap pas hapi.</p> <p>Studentët e UART janë të përfshirë edhe në jetën artistike kulturore të vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në shfaqje dhe aktivitete të tjera teatrore në tri institucionet kryesore të Tiranës (Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” dhe Teatri i Metropolit) apo teatro të rretheve dhe nismave të tjera private. Ky bashkëpunim është rritur edhe më tej nëpërmjet marrëveshjeve që UART ka realizuar me institucionet kulturore artistike në kuadër të iniciativës “Paktit për Universitetin”.</p> <p><i>(Evidencë Nr. 2.13, 2.14 Marrëveshje bashkëpunimi të UART)</i> <i>(Evidencë 3.6 UMASR Nr. 512, datë 24.10.2019)</i> <i>(Evidencë 3.6 UMASR Nr. 52, datë 03.12.2015)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimave, struktura e vitit akademik, formularë të ndryshëm, modele të testeve/provimeve që përdoren në institucion, aplikime për bursë, mund të aksesohen në ambjentet e hapura në Fakultetin e Artit Skenik, po ashtu edhe nëpërmjet ëeb faqes të institucionit.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore e FAS e cila mban kontakte të rregullta me studentët</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	që ndjekin programin e studimit nëpërmjet komunikimeve elektronike.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informimi i studentëve, realizohet nëpërmjet platformës Microsoft Teams dhe Pitagora, sikurse pohuan edhe vetë studentët gjatë takimit fizik, arrijnë të ndërveprojnë gjatë realizimit të procesit mësimor, platforma të cilat kanë shërbyer për zhvillimin e procesit mësimor dhe artistik edhe gjatë periudhës së Pandemisë. Ndërsa informacioni mbi kurrikulat e studimit, aktivitetet dhe kalendarin mësimor publikohen online dhe janë lehtësisht të arritshëm nga studentët në distancë. (Evidencë 3.2 Kurrikula e Programit të Studimit Master) (http://uart.edu.al/media/skenografi-kostumografi-dhe-mesuesi-master-2021.pdf)			
Konkluzione	GVJ konstaton se UART vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër të Rregjistrimit themeltar, Rregjistrimit të arritjeve akademike, Rregjistrimit të kursit dhe Rregjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e rregjistrimit apo edhe të transferimit. Një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave të studentëve si ato që ndjekin programin e studimit por edhe atyre studentëve që janë diplomuar është sekretaria mësimore e FAS e cila funksionon

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>mbi bazën e detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Referuar vizitës në sekretarinë mësimore rezultojnë të jenë regjistruar në këtë program studimi:</p> <p>Në vitin akademik 2020-2021 4 studentë;</p> <p>Në vitin akademik 2021-2022 10 studentë;</p> <p>Për periudhën 2018-2022 janë diplomuar gjithsejt 13 studentë. Mbajtja e statistikave të studentëve mbahet edhe në Sekretarinë e Statistikave, pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në UART. Për arsye të ruajtjes së konfidencialitetit jo gjithmonë këto të dhëna janë objekt i bërjes publike.</p> <p><i>(Evidencë 6.19 Të dhëna statistikore FAS)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore. Të dhënat ruhen në regjistra përkatës dhe në formë elektronike. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit Master i Arteve në "Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi".</p> <p><i>(Evidencë RVB, Takimi në Sekretarinë mësimore).</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ dekalron se Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen në format letër (në regjistrat përkatës) si dhe në Sistemin e Pitagora, ku stafi akademik hedh të dhënat dhe ndjek ecurinë e studentëve përgjatë vitit akademik, po ashtu edhe vetë studentët mund të ndjekin ecurinë e tyre, si dhe të informohen për mungesat, vlerësimet, etj. përmes sistemit. Informatizimi i shërbimeve për administrimin e Studimeve dhe Kurrikulës, ka filluar zbatimin që nga viti 2013.</p>

	<i>(Evidencë RVB, Takimi në Sekretarinë mësimore)</i>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Me Vendim të Senatit Akademik Nr 21, datë 07.10.2021, në Universitetin e Arteve, është miratuar Rregullorja e Sektorit Mësimor, e cila përcakton se ky sektor është që kryen kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> <p>Gjatë takimit me këtë Sektor, GVJ u informua se ky sektor kryen herë pas here kontrole në përfundim të vitit akademik, në sekretaritë mësimore duke vëzhguar nga afër regjistrat e arritjeve akademike (regjistri i notave) duke krahasuar një sistem të rastësishëm se si janë hedhur notat në këtë rregjistrë nga stafi i sekretarisë. Është fakt, që nuk është vërejtur asnjë problem serioz në keq hedhjen e notave apo edhe të ndryshimit të tyre. <i>(Evidencë 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor UART)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Gjatë takimeve në Institucion, GVJ u takua me përgjegjësin e Departamentit të S&K, i cili bëri një pasqyrim në lidhje me punën e tij por edhe me mbarëvajtjen e këtij Departamenti. Po sipas Përgjegjësit të Dep, realizohet për çdo vit akademik një raport analitik, ku prezanton cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi. Në këtë Raport paraqitet dhe pasqyrohet në formë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike në Departamentin e S&K, procesin e mësimdhënies dhe të nxënit, përqindjen e të diplomuarve, numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit, numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit që ofron UART, pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre, cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi. Pjesë e analizës vjetore janë edhe sugjerimet dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve. Departamenti në bashkëpunim me zyrën e Alumnit ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me</p>

	<p>ecurinë e tyre në tregun e punës dhe mbështeten e tyre të mëtejshme nëpërmjet kualifikimit të vazhduar apo edhe paraqitjen e mundësive për punësim, si dhe me marrjen e mndimit të tyre në lidhje me vlerësimin e dijeve dhe aftësive që ato kanë marrë gjatë periudhës së studimeve në FAS. Propozimet e tyre për përmirësime në programin e studimit janë parë gjithnjë me vlerë dhe të kanë qënë gjithmonë të mirëpritura. (Evidencë Nr 2.12 raporti i analizës vjetore S&K/FAS)</p>		
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se të dhënat për studentët që në rregjistrimin e tyre dhe deri në përfundim të studimeve janë të mirëmbajtur nga Sekretaria Mësimore e FAS.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ ju komunikua se që me miratimin e Statutit të ri të UART të MASR Nr 3937/5, datë 15.09.2021; me VSA Nr 15, datë 30.08.2021, studentët përfaqësohen në Senatit Akademik të UART prej 19 anëtarësh me 2 studentë, duke forcuar zërin e tyre në ngritjen e problemeve por edhe duke patur në konsideratë edhe zgjidhjen e tyre. Studentët përfaqësohen në të gjitha nivelet në UART, duke filluar që nga Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli studentor, etj. (Evidencë 1.15 Statuti i UART Kreu IX, neni 126)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin</p>	<p>GVJ ju komunikua se me vendim të Senatit Akademik Nr 22, datë 07.10.2021 është miratuar Rregullorja e Komisionit të marrdhënieve me studentët. Objekti kryesor i ngritjes së këtij komisioni është sigurimi në një nivel cilësor i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe të bashkëpunimit të ngushtë me studentët, pedagogët përkatës si dhe njësitë e brendshme të ngritura në</p>





<p>akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UART, duke garantuar dhe zhvilluar mbarrëdhëniet e bashkëpunimit midis organeve drejtuese të UART dhe të studentëve të tij. Misioni i këtij komisioni është bashkërendimi i punës së stafit akademik, stafit administrativ dhe e studentëve si dhe monitorimi i zbatimit të procedurave të aprovuara nga organet drejtuese për të gjithë procesin mësimor në aspektin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Një tjetër formë është dhe ajo e përfaqësimit me një anëtar grupi pune në grupet e punës të vlerësimit të brendshëm të akreditimeve të programeve apo akreditimit institucional. Edhe në hartimin e këtij raporti të vlerësimit të brendshëm, është përfshirë një student nga Programi i Studimit Master i Arteve në “Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi”.</p> <p><i>(Evidencë 6.9 Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor)</i></p> <p><i>(Evidencë 6.10 Raporti mbi gjetjet e sondazhit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Gjatë takimit me Sektorin mësimor, GVJ u informua se në Universitetin e Arteve, si një institucion me veprimtari specifike siç është fusha e artit dhe me një numër të kufizuar studentësh, njësia përgjegjëse që garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi është Sektori Mësimor. Ky sektor, organizon sondazhe nëpërmjet pyetësorve për të mbledhur të dhëna lidhur me mësimdhënien, programet e studimit, facilitetet, burimet materiale, logjistikën dhe shërbime të tjera. Gjetjet e këtij raporti i bëhen të ditura nëpërmjet një raporti Rektorit të UART.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit të miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr 37, datë 20.07.2022, neni 21, përcaktohet se studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni i provimit jo më vonë se tre ditë pune nga data e dhënies së provimit. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatin e marrë. Komisioni është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjen e dokumentuar ose rregjistrimet (kur ka) të studentit më tezën e zgjidhur.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Nga takimet me studentët GVJ u informua se nuk ka patur problematika të evidentuara në lidhje me procesin e vlerësimit të tyre nga ana e pedagogëve.</p> <p>(Evidencë 2.3 Rregullorja FAS)</p> <p>(Evidencë Rregullore e Programit të studimit, neni 21, pika 11,12,13)</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se FAS përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Institucion pati mundësinë që përveç Sektorit mësimor, Sekretarinë Mësimore, të informohet edhe për përfaqësuesin e sektorit të projekteve.</p> <p>Gjat takimit me këto sektorë, u informuam se Universiteti i Arteve ka ngritur njësi me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve siç janë: Sekretaria Mësimore dhe Sektorin Mësimor i cili në përbërje të tij ka edhe strukturën e “Informimit të studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe Koordinatorin i Institucional. Këto zyra ndjekin ecurinë e studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar këshillim për çështje akademike, në shërbim të procesit mësimor, si dhe ato studentore. Sipas rregullores se sektorit mësimor, ky sektor ka si detyrë: Ndjekjen, gjurmimin dhe rritjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me studentët aktualë dhe me studentët e diplomuar. Studentët e diplomuar të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>Universitetit të Arteve janë të gjithë artistë të mirëfilltë si dhe specialistë të lartë të fushës së mësuesisë sipas profilit në të cilin janë diplomuar. Kontributi i tyre në fushën e artit është i pazëvendësueshëm. UART është pjesë e rëndësishme e projektit GRADUA, projekt i cili do të mbështesë Universitetet Shqiptare duke implementuar një model të integruar të kërkesës bazuar në bazën e të dhënave të të diplomuarve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mbledhjes së të dhënave për performancën e të diplomuarve; b) lehtësimin e bashkëpunimit midis institucioneve të arsimit të arsimit të lartë dhe biznesit; c) lehtësimin e vendosjes së të diplomuarve në tregun e punës. <p><i>(Evidencë 5.19 Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Bazuar edhe sipas të dhënave në web faqen e FAS/UART dëshmohet se përveç Sekretarisë Mësimore dhe Sektorit Mësimor i cili në përbërje të tij ka edhe njësinë e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni si dhe Koordinatorin i Institucional, përdoret me efikasitet të plote faqja e ëeb-it të UART si dhe së fundmi sistemi PITAGORA në koordinim të plotë me Rrjetin Akademik Shqipëtar. Në këtë sistem informohen studentët si për rezultatet e tyre ashtu edhe me gjithçka tjetër në lidhje me procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione</p>	<p>Gjatë takimit me Sektorin Mësimor, GVJ u informua se ky Sektor, ka pjesë të tij edhe Informimin e Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Specialist i këtij Sektori është edhe Koordinatori Institucional, që mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Sektori mësimor një nga detyrat e tij ka edhe mbajtjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me këshillat studentorë; drejtimin e procesit të këshillimit të studentëve; mbajtjen e komunikimit me tregun e punës, si dhe ofrimin e asistencës në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve në fushën e artit dhe kulturës. Po ashtu zyra ruan lidhje të ngushta me Këshillin</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



73




të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>Studentor dhe bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të ndryshme të propozuara prej studentëve. Gjithashtu, zyra bashkëbisedon me studentët e viteve të para për t'u prezantuar atyre: institucionin, programet, mundësitë e punësimit etj.</p> <p><i>(Evidencë 2.2 Rregullorja e ciklit të II të studimit)</i> <i>(Evidencë 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor UART)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Gjatë takimit me Sektorit mësimor, GVJ u informua se në përbërje të Sektorit Mësimor, funksionon edhe Struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në UART. Kjo strukturë, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale, etj. Për të shmangur të dhënat sensitive dhe për të garantuar ish studentët e UART, Sektori mësimor ka përgatitur një formular ku i fton ish studentët të plotësojnë me vullnet të lirë të dhëna që konsiderohen sensitive si numri i kontaktit apo edhe adresë email, duke i siguruar që këto të dhëna janë vetëm për database të Alumni të UART.</p> <p><i>(Evidencë 6.7 Rregullorja e Sektorit Mësimor UART)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se në UART funksionon më së miri gjithçka që lidhet me studentët dhe me problemet apo edhe me specifikat e tyre si asrtistë të së nesërme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1



Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Në rregulloren e Fakultetit të Artit Skenik si dhe në Rregulloren e ciklit të II të studimit Master, janë të pasqyryara qartësisht udhëzimet për zhvillimin e kurrikulës dhe përdorimin e metodave bashkëkohore që duhen përdorur në procesin mësimor. Ato orientojnë për punën që duhet bërë në lidhje me hartimin e sylabuseve lëndore, përzgjedhjen e literaturës, metodat bashkëkohore, sistemin e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve të studentëve, këshillimin akademik dhe tutoriatin, etj.</p> <p>Për trajnimin e stafit akademik për njohuri profesionale dhe akademike në fushën e formimit pedagogjik të mësimdhënies UART ka realizuar një Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin e Shkencave Sociale, UT</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademi.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me Komisionin <i>Ad Hoc</i> për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë ju komunikua se një nga mekanizmat më të përdorur për monitorimin dhe vlerësimin periodik të ecurisë së programeve të studimit dhe aftësive mësimdhënëse të personelit akademik, janë sondazhet dhe pyetësorët të zhvilluara me studentët dhe pedagogët nga Sektori Mësimor apo edhe nga vetë departamentet. Ishte e qartë që strukturat kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në UART janë njësitë bazë. Këto Njësi apo Departamente mbështeten në strukturat përkatëse si Sektori mësimor, i Kurrikulave dhe Informimit të studentëve si dhe Sekretariatë mësimore pranë secilit Fakultet, duke koordinuar punën për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni ndjek politika mbështetëse për kualifikimin e personelit akademik për të kontribuar në këtë mënyrë në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kjo politikë, konsiston edhe në mbështetjen e mobilitetit të personelit akademik, me qëllim përfundimin e eksperiencave dhe metodologjive të reja të mësimdhënies. Një aspekt i rëndësishëm</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>në përmirsimin e cilësisë së mësimdhënies është trajnimi i stafit akademik në fushën e cilësisë së edukimit. S&K/FAS ka zhvilluar disa takime në parim me Fakultetin e Shkencave Sociale për të mundësuar trajnime, seminare dhe konferenca me qëllim ngritjen e nivelit mësimdhënës të pedagogëve të rinj nga pikëpamja pedagogjike dhe azhurnimi me idetë e reja të po këtyre aftësive pedagogjike ndër pedagogët tashmë me përvojë të në S&K. Ishte menduar që pas këtyre takimeve për stafin akademik të shperndahen edhe çertifikatat përkatëse. Të gjitha këto garantohen nga rregulloret e departamentit, programit të studimit.</p> <p><i>(Evidencë 2.2 Rregullorja e Ciklit të II-të të Studimit)</i></p> <p><i>(Evidencë 2.4 Rregullorja e Departamentit S&K)</i></p> <p><i>(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit S&K)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ ju komunikua gjatë viztës në institucion se për vetë specifikën e procesit mësimor, ku studiot dhe atelietë janë laboratorë të mirëfilltë kërkimorë, procesi mësimor parashikon përfshirjen e studentit në çdo hap, nisur që nga paraqitja e programit të lëndës, hapat e realizimit të tij, te informimi për mënyrën e vlerësimit e deri te paraqitja e provimeve para publikut. Studentët në UART kanë të gjithë vëmendjen e duhur si nga personeli akademik ashtu edhe nga ai administrativ. Ashtu siç jemi shprehur edhe në kriteret e mësipërme, GVJ deklaroi se studentët kanë të drejtë edhe të ankimimit për vlerësimet e tyre, fillimisht në departamentet përkatëse, e më pas në Dekanat apo Rektorat.</p> <p><i>(Evidencë 2.2 Rregullorja e Ciklit të II-të të Studimit)</i></p> <p><i>(Evidencë 2.3 Rregullorja e FAS)</i></p> <p><i>(Evidencë 2.7 Rregullorja e UART)</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Mbështetur edhe në RVB, GVJ shprehet se gjatë takimeve në Institucion, ju bë e qartë se rezultatet e monitorimit të cilësisë së programeve të studimit, të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve, nëpërmjet pyetësorëve, bëhen publike nëpërmjet afishimit të tyre fizikisht në vende të dukshme në mjediset e brendshme të FAS, takimeve informuese me pedagogët dhe studentët, kontakteve me Këshillin Studentor të</p>


	UART si dhe analizave vjetore të departamenteve. Ato publikohen periodikisht në faqen ëeb të UART.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nxjerrja e rezultateve të monitorimit të cilësisë së programeve të studimit, të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve nëpërmjet pyetësorëve, evidenton shembuj të praktikave të mira dhe brenda kufijve të etikës, duke nxitur stafin akademik për përmirësim të proceseve të mësimdhënies, të programeve të studimit dhe të vlerësimit të dijeve sipas kërkesave bashkëkohore.			
Konkluzione	GVJ deklaron se FAS dhe Departamenti i Skenografi-Koreografi ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nu përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Edhe gjatë takimit me Dekanin dhe Përgjegjës të S&K, por edhe gjatë takimit me Komisioni Ad Hoc, GVJ ju komunikua se Struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm është Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Organizimi dhe funksionet e komisionit janë të parashikuara në Statutin e UART. Për Sigurimin e brendshëm të cilësisë, ishte ngritur edhe Komisioni Ad Hoc me Urdhër të Rektorit të UART. Sipas deklarimeve të tyre, Komisioni bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, Manualin për Procedurat

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, Statutin e UART. Ky Komision është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion.</p> <p><i>GVJ rekomandon që UART të ngrëjë sa më shpejt NJSBC si strukturë, ashtu sic e ka parashikuar edhe në Statutin e saj.</i></p> <p><i>(Evidencë Statuti i UART, neni 35)</i> <i>(Evidencë RVB; Manuali i Sigurimit të Cilësisë)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ ju komunikua se duke qënë se Sigurimi i Cilësisë është një proces i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë të të gjithë Universitetit të Arteve në përgjithësi por edhe të të tre Fakulteteve, pjesë kryesore e këtij Universiteti, është menduar që në përvërjen e këtij Komisioni të jenë: Zv Rektorit për anën mësimore, Zv Rektori për projektet artistike dhe shkencore, një Përgjegjës Departamenti nga Fakulteti i Artit Skenik, një Përgjegjës Departamenti nga Fakulteti i Arteve të Bukura, një Përgjegjës Departamenti nga Fakulteti i Muzikës, si dhe i gjithë Sektori Mësimor&Kurikulës.</p> <p>Pjesë e këtij Komisioni për FAS ishte Përgjegjësi i Departamentit të RRFTV, i cili ja shtjelloi gjerësisht GVJ të gjithë specifikën dhe mënyrën e funksionimit të këtij Komisioni. Referuar RVB, ndër politikat dhe rregulloret që standardizojnë funksionimin dhe detyrat apo angazhimin e Sigurimit e Brendshëm të Cilësisë përmenden: Organizimi i Brendshëm i Cilësisë; Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve dhe Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit. Dokumenti kryesor që rregullon punën e këtij Komisioni është Manuali i Sigurimit të cilësisë. Për vjeljen e informacionit mbi ecurinë e programit dhe performancën e personelit etj. përdor një numër vlerësimesh si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies; - Vlerësimi nga studentët për institucionin; - Vlerësimi i studentëve për programin;

	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i stafit për institucionin - Vlerësimi i Rektoratit për strukturat menaxhuese; <p>Vlerësimi i stafit nga instancat drejtuese (Dekan/Zv.Dekan).</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë garantohej nga vetë institucioni dhe menaxhohet nga Komisioni Ad Hoc. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimi organizohet në mënyrë periodike nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). UART i është akorduar riakreditimi institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.17, dt. 24.03.2022 duke e vlerësuar pozitivisht me vlerësimin maksimal, me kohëzgjatje 6 vite akademike. Ndërsa programi i studimit Master i Arteve në “Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi”, ashtu si edhe të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në FAS por edhe në UART, po i nënshtrohen akreditimit për herë të parë të tyre.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ ju komunikua se praktika që ndiqet për ndryshime dhe përmirësime të programeve të studimit, në funksion të rritjes së cilësisë, është e përcaktuar dhe në përputhje me Rregulloret për funksionimin e Fakultetit dhe Rregulloret Mësimore të dy cikleve të studimit me kohë të plotë Bachelor dhe Master. Një nga treguesit më të matshëm për cilësinë e programeve të studimit dhe mësimdhënies në Universitetin e Arteve, është punësimi i studentëve të tij si brenda dhe jashtë vendit, në institucione prestigjioze të fushës së arteve që përbën edhe një nga pikat e forta të diplomuarve në këtë program studimi.</p> <p><i>(Evidencë 2.2 Rregullorja e ciklit të II të studimit)</i> <i>(Evidencë 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit Master)</i> <i>(Evidencë 3.20 Vërtetim punësimi nga ish studentë)</i></p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ deklaroi se UART zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet plotësisht</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.

Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.

Mbikëqyrja e herëpashershme e programit të studimit Master i Arteve në "Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi" bazohet në vjeljen e informacionit nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen në fund të çdo semestri e që i kushtohen vlerësimit të programit të studimit dhe personelit akademik (*Evidencë Model Pyetesori*). Vlerësimi i programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Artit Skenik kryhet duke analizuar përputhshmërinë me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit, treguesit e matshëm, zhvillimin e programeve të studimit dhe vlerësimin, të dhëna për zhvillimin e teknologjisë në vend lidhur me programet e studimit si dhe duke formuluar gjetje dhe rekomandime. Gjetjet dhe përgjigjet në këto pyetësor shqyrtohen në Departament duke shqyrtuar problematikat e hasura dhe ecurinë e mësimdhënies për çdo pedagog. Departamenti analizon të gjitha elementët e realizimit të tij, si mbulimi me materiale studimore, realizimi i formave të kontrollit të vazhdueshëm dhe provimit përfundimtar të lëndëve, realizimi i praktikave profesionale, realizimi i punimeve të diplomave dhe bën propozimet përkatëse për ndryshime, nëse e vlerëson të arsyeshme.

Për të bërë këtë analizë, departamenti mbështetet në sugjerimet dhe komentet e stafit mësimdhënës, në anketimet e studentëve, si dhe në të dhëna që gjenerohen nga sekretaritë mësimore. Departamenti shqyrton analizat e programeve të studimit që mbulon dhe përcjell në dekanat raportin e analizës mësimore të departamentit. Dekanati harton raportin e analizës mësimore të fakultetit, të cilën e përcjell në rektorat.

(Evidencë 6.9 Sondazhet e bëra nga Sektori Mësimor)



(Evidencë 2.12 Raporti vjetor i S&K)

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, një formë e vlerësimit sidomos për stafin akademik është edhe vlerësimi i tij prej strukturave përgjegjëse e drejtuese në fund të çdo viti akademik. Njësitë kryesore pasi marrin në dorëzim raportet, i analizojnë konkluzionet me stafet e tyre akademike, ku ftohen dhe përfaqësues të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të dhënë komentet përkatëse, dhe ndërmarrin veprime me hapa konkretë për përmirësimin e situatës. Sipas RVB, në formatin e vetëvlerësimit të stafit akademik, strukturat menaxhuese kur e shohin të arsyeshme kanë mundësi të bëjnë komente dhe sugjerime për secilin pjestar të stafit. GVJ u informua se mbi bazën e vlerësimeve të përsëritura negative, ka patur raste të mosrinnovimit të kontratës për personelin akademik (<i>Evidencë Takim me Komisionin Ad Hoc</i>). Në disa raste, për të adresuar problematikat e konstatuara, janë zhvilluar trajnime si për shembull për kuptimin e kurrikulës nga stafi i ri, përdorimin e teknikave të mësimdhënies etj.</p> <p>(<i>Evidencë RVB; Takime në institucion</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i</p>	<p>Referuar RVB, metodat e drejtpërdrejta të përdorura në procesin e vlerësimit kanë përfshirë, takimet e autoriteteve drejtuese me studentët, takimet e autoriteteve drejtuese me qeverinë studentore, takimet e përgjegjësve të departamenteve me studentët e programeve të studimit, takimet me studentët ALUMI, vëzhgime në auditor për metodat dhe pedagogjinë e mësimdhënies së stafit akademik apo angazhimin e studentëve, vlerësimet e testeve dhe ecuria gjatë një viti akademik e studentëve programit, analizë e problematikave lidhur me frekuentimin dhe kalueshmërinë etj.</p> <p>GVJ pati rastin të konfirmojë një pjesë të këtyre elementëve gjatë takimeve në institucion me stafin akademik, studentët, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe Komisionin Ad Hoc të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>

shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.				
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademi e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Referuar RVB, institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si pyetësorë, anketime, raporte vjetore, raporte vlerësimi programi, raporte vlerësimi prej strukturave drejtuese, vetvlerësim të stafit akademik, pyetësorët me studentët ALUMNI, vlerësimet e studentëve ALUMNI, gjurmimin e studentëve dhe mbledhjen e të dhënave për punësimin (për punësimin në profil ose jashtë profili etj), takimet me ALUMNI në institucion, gjatë trajnimeve ose në sipërmarrjet ku ata punojnë. Sektori Mësimor, Alumnit dhe Karrierës, realizon studime periodike të punësimit të studentëve dhe zotëron një databazë të studentëve të punësuar. Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit në institucion. (<i>Evidencë Dosja e Vetvlerësimit, Takime në institucion</i>)</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se UART monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion menaxhohet nga Komisioni <i>Ad Hoc</i> për Sigurimin e Cilësisë, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në varësi edhe të fushës së ekspertizës, aktorët e brendshëm angazhohen më tepër në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësidhënies në gjithë elementët përbërës të saj, ndërsa aktorët e jashtëm kontribuojnë në drejtim të përshtatjes së programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. I gjithë aktiviteti i këtij Komisioni bazohet në Statutin e UART, bazën Rregullative të UART dhe në mënyrë të veçantë në Manualin e Sigurimit të cilësisë. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit nga NJSBC me rëndësi konsiderohet edhe informacioni dhe eksperiencat e përftuara në kuadër të mobiliteteve në universitete jashtë vendit.</p> <p>(Evidencë <i>Takime në institucion; Marrëveshjet në kuadër të Erasmus+</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Referuar RVB, përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë dhe strukturat e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në dokumentet bazë si Organizimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit, Manualin e Sigurimit të cilësisë.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, anëtarët e këtij komisioni dhe këtij sektori, kanë përgjegjësi dhe detyra konkrete dhe të ndryshme, në përshtatje edhe me rolet që ata kanë në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik,</p>	<p>Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së programit të studimit Master i Arteve në "Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi" është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës. Nga takimi me GVB, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj, për të mundësuar një vlerësim real të programit të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit. <i>(Evidencë RVB; Takime me GVB)</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit Master i Arteve në “Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi”, në veprimtarinë e saj, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë mbështetet nga Universiteti i Arteve në përgjithësi si dhe nga Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamenti i S&K në veçanti. Në punën e saj ky Komision zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti. Institucioni nuk ka asnjë rast të ngritur ose të regjistruar të diskriminimit apo pabarazisë së ushtruar ndaj personelit ose studentëve. <i>(Evidencë 4.8 Kodi dhe Rregullorja e Këshillit të Etikës)</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Referuar RVB, Fakulteti i Artit Skenik ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me artistë të njohur të fushave të ndryshme të artit si brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet angazhimit të tyre në procesin e mësidhënies si pedagogë me kohë të pjesshme. Nëpërmjet zhvillimit të shkëmbimeve të drejtpërdrejta me regjisorë, aktorë, pedagogë, dramaturgë vendit apo të huaj nga rajoni apo më gjerë, vazhdimisht merret ekspertizë e vlefshme lidhur me programet e mësimin, cilësisë dhe përafrimin e tyre me programet e IAL simotra dhe cilësinë e mësimdhënies, nëpërmjet ballafaqimit të nivelit të përgatitjes së studentëve në këto masterclass-e. Ekspertiza dhe sugjerimet e tyre vijnë nëpërmjet tryezave të rrumbullakëta, aktiviteteve të përbashkëta, mbledhjeve etj. Në këto rast është konsideruar me prioritet opinionin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për të vlerësuar dhe pasqyruar elementë që lidhen me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. <i>(Evidencë 4.1 Shfaqje apo takime me regjisorë/aktorë/skenografë/koreografë, etj)</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ shprehet se UART përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Web faqja e UART është lehtësisht e verifikueshme me të gjithë informacionin e saj. UART, FAS, ka në politikën e tij bërjen e transparencës për të gjithë aktet rregullatorë, Vendime të Senatit Akademik, të Bordit të Administrimit si dhe çdo veprimtari tjetër të njësive të tjera, në faqen e web-it të universitetit.</p> <p><i>(Evidencë 1.15 Statuti i UART, neni 76)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Sips RVB, parimet mbi të cilat ndërtohet Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë janë të përcaktuara në Rregulloren e Sektorit Mësimor dhe i Kurrikulës si dhe në Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Cilësisë. Janë këto parime që sigurojnë garantimin e transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e njësive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj. Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit, për transparencë, ju ishte dërguar me email të gjithë stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të Fakultetit të Artit Skenik, një pjesë e të cilëve nuk ishin pjesë përbërëse e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm.</p> <p><i>(Evidencë 5.19 Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p><i>Mësimore FAS)</i></p> <p>Nga takimi në institucion GVB u informua për elementë të cilët kanë qenë në fokusin e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit e që kanë rezultuar nga anketimet e kryera. Po ashtu në raportet e përgatitura për instancat e ndryshme ka elementë të rekomandimeve apo përmirësimeve të nevojshme. Një rol të posaçëm luan dhe Sektori Mësimor dhe i Kurikulës, si dhe Sektori i TI, duke përgatitur raporte me përmbledhje të dhënash lidhur me përgjigjet e pyetësorëve. Gjithashtu, GVJ është i mendimit se, adresimi i problematikave të konstatuara gjatë hartimit të RVB dhe të dala gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm dhe vendimit të Bordit të Akreditimit për akreditimin institucional, vlerësim i dhënë së fundmi, konfirmojnë angazhimin e institucionit në këtë drejtim.</p> <p><i>(Evidencë 2.12 Raporti vjetor i FAS)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Procesi i vlerësimit dhe sigurimit të efektivitetit dhe impaktit të veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit është një proces kompleks i cili kërkon angazhimin e të gjithë strukturave të institucionit. Në nivel institucioni kjo, sipas RVB, realizohet përmes strategjive, matshmërisë së realizimit të objektivave, studimeve të tregut, raporteve, analizave, vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme, pyetësorëve dhe anketimeve, angazhimin të ekspertëve dhe të gjitha instrumenteve të tjera akademike dhe administrative.</p> <p><i>GVJ është i mendimit që, një proces i monitoruar në mënyrë më të përqëndruar, do të kishte një impakt më të spikatur në përmirësimin e sigurimit të cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ ju konfirmua nga disa drejtime se një sërë takimesh janë realizuar me stafin akademik të bendshëm dhe të jashtëm në kuadër të riakreditimit institucional të UART, proces i cili u mbyll me një vlerësim maksimal. Sipas RVB, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Sektori Mësimor dhe i Kurikulës, organizojnë veprimtari periodike me personelin dhe me studentët për informimin, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre mbi sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet pyetësorëve të zhvilluar për këtë qëllim. Një</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


	sërë takimesh janë realizuar edhe nga Komisioni AD Hoc i të gjithë procesit të akreditimit të programeve. Vetë përbërja e këtij Komisioni tregon për rëndësinë që ka sigurimi i Cilësisë në këtë Institucion.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton e Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në “Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi”

a. Pika të forta:

1. Programi është inicuar nga UART, referuar një studimi të mirefilltë të tregut dhe vjen për të përmbushur nevojat e arsimit parauniversitar ku dija rreth disiplinave të Artit/Arteve, zhvillohen si disiplinë shkollore, dhe kanë hapësirën legale te detyrueshme për tu përmbushur, brenda kurrikulës zyrtare në sistemin e arsimit parauniversitar ne tri cikle: nga cikli i ulët, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë.
2. Kurrikula e programit në fjalë {dija skenografike dhe kostumografia} rezulton e ballancuar referuar disiplinave bazë {ato me thekse në shkencat e edukimit dhe mësimdhënjes, me disiplinat karakterizuaes {disiplinat specifike, të mirëfillta skenografi/kostumografi.}.
3. Syllabuset e disiplinave janë hartuar referuar skemës së kërkuar nga ligji për arsimin e lartë, shkruar me një gjuhë të sofistikuar dhe të përkthyer e përthyer në ECTS referuar sistemit të Bolonjës.
4. Mjediset fizike ku përmbushet programi janë të shfrytëzuara seriozisht dhe brenda kufinjve që parashikon ligji dhe në raport të drejtë student/metër katror.
5. Staf i akademik, {i brendshëm dhe i jashtëm} rezulton me Tituj / Grada konform kërkesave të ligjit për arsimin e lartë.
6. Biblioteka paraqitet institucion mjaft serioz, literaturë të pasur dhe të organizuar kryesisht në dy disiplinat e artit të Skenografisë dhe Kostumografisë, por Shkencat e edukimit ishin në process të pasurimit dhe sistemimit të tyre;

b. Pika të dobëta:

1. Kurrikulës, i mungon Disiplina e Etikës si disiplinë ku pikëpritet edukimi me artin. Kjo disiplinë mund të gjeje hapësire qoftë dhe në {4 ETCS} në lëndët nderdisiplinare, apo disiplinat bazë; *(Standart II.1 kriteri 5)*





2. Numër i kufizuar i literaturës në fushat e shkencave të edukimit, gje që duhet balancuar me literaturën e pasur që kishin disiplinat e arteve respective; (*Standart III.6 kriteri 1*)
3. Mungesa e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë sipas akteve ligjore dhe rregullatore të Institucionit; (*Standart IV.2 kriteri 1*)

c. Rekomandime

1. Sygjerohet që të rishihen mundësitë për tu ri-pare raportet ndërdisiplinore {I referohemi dijes baze, dijes karakterizuese, dijes ndërdisiplinare, dijes me zgjedhje} të lihet pak më shumë hapësirë dijeve nga fusha e shkencave të edukimit dhe mesimdhënies. Etika si dije dhe kodet etike, si rregullatore të konfirmuar, respektivisht në Institucionin e shkolles dhe në fushën e artit, është dija e munguar, ose vjen disi anemike;
2. Të potencohet krijimi i një liste me “Mentore” dhe Institucioni të prodhojë politika për trajnimin e tyre {mentoreve, minimalisht një herë në vit duke ju dhënë statusin e mentorit};
3. Sugjerohet që biblioteka, të pasurohet me tej në tituj literaturë në fushat e shkencave të edukimit dhe metodologjite e mesimdhënjes;
4. Rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë referuar, Nenit 35 të Statutit UART;
5. Marrëveshjet për praktikën profesionale duhet të jenë më të specifikuara dhe me detyrime reciproke nga dy institucionet {shkollat pritëse dhe UART duhet të kenë saktësisht detyrimet reciproke};
6. Politikën e IA për të “ftuar” student të rinj të diplomohen si mësues në arte, pritet të jenë me fleksibile, dhe strategjike;
7. Praktikën profesionale {praktikat në klase si mesimdhens} nuk na rezultojnë aq të mirëorganizuar sa praktikën mësimore përgjatë vitit. Mungonte lista e pedagogëve që do të udhëheqin praktikën në Sistemin parauniversitar dhe mungonte lista e mësuesve mentor¹ në shkollat respective ku pritet të bëhet praktika profesionale, mungonte një format-tip ku

¹ Mësuesi mentor konsiderohet si koncept i rëndësishëm në shkencat e mësuesisë. Mësuesi që ka këtë status, të cilin ia jep institucioni ku ushtron mesimdhënie, por dhe institucioni IA që percjell studentet për të bërë praktikën. Egziston literaturë ku është e elaboruar kompetenca e monitorimit dhe formatet që përbushin monitorimin si proces.





do të referohen mësuesit mentor për të bërë vlerësimin e studentit/es në mbyllje të praktikës në institucionet shkollore;

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




90

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Arts in "Scenography - Costume Design and Teacher"

a. Strengths and affirmations:

1. The program was initiated by UART, referred to a real market study and comes to meet the needs of pre-university education where knowledge about the disciplines of Art/Arts, are developed as a school discipline, and have the legal space to be fulfilled, within the curriculum official in the pre-university education system in three cycles: from the lower cycle, lower secondary and higher secondary;
2. The curriculum of the program in question {scenographic knowledge and costume design} is balanced with reference to the basic disciplines {those with emphasis on the sciences of education and teaching, with the characteristic disciplines {the specific, genuine disciplines of scenography/costume design.};
3. The syllabi of the disciplines are drawn up referring to the scheme required by the law on higher education, written in a sophisticated language and translated into ECTS referring to the Bologna system;
4. The physical environments where the program is carried out are used seriously and within the limits provided by the law and in a fair student/square meter ratio;
5. The academic staff, {internal and external} results with Titles / Degrees in accordance with the requirements of the law on higher education;
6. The library is a very serious institution, rich literature and organized mainly in the two art disciplines of Scenography and Costume Design, but the Sciences of education were in the process of enriching and systematizing them;


b. Weak points:



1. The curriculum lacks the Discipline of Ethics as a discipline where education with art is expected. This discipline could find space even in {4 ETCS} in interdisciplinary subjects, or basic disciplines; *(Standard II.1 criterion 5)*
2. Limited number of literature in the fields of educational sciences, something that must be balanced with the rich literature that the disciplines of the respective arts had; *(Standard III.6 criterion 1)*
3. Absence of the Internal Quality Assurance Unit according to the Institution's legal and regulatory acts; *(Standard IV.2 criterion 1)*

c. Recommendations

1. We suggest that opportunities to re-look at inter-disciplinary relationships {We refer to basic knowledge, characterizing knowledge, interdisciplinary knowledge, elective knowledge} to leave a little more space for knowledge from the field of education and teaching sciences. Ethics as knowledge and ethical codes, as confirmed regulators, respectively in the School Institution and in the field of art, is the missing knowledge, or it comes somewhat anemic;
2. Emphasize the creation of a list of "Mentors" and the Institution to produce policies for their training {mentors, at least once a year, giving you the status of a mentor};
3. We suggest that the library be further enriched with literature titles in the fields of educational sciences and teaching methodologies;
4. It is recommended to set up the NJSBC and the Permanent Commission for Internal Quality Assurance referred to Article 35 of the UART Statute;
5. Agreements for professional practices should be more specified and with mutual obligations from the two institutions {host schools and UART should have exactly the same mutual obligations};
6. IA policies to "invite" young students to graduate as teachers in the arts are expected to be more flexible and strategic;
7. Professional internships {internships in the classroom as in the middle} are not as well organized as educational internships throughout the year. The list of lecturers who will



guide the practices in the pre-university system was missing and the list of mentor teachers² in the respective schools where the professional practice is expected to take place was missing, a format-type was missing where the mentor teachers will be referred to evaluate the student at the end of the practice in school institutions;

² The mentor's teacher is considered an important concept in the sciences of succession. The teacher who has this status, which he gives to the institution where he teaches, but also the IAI institution that persuading students to do the practice. There is a reading where the monitoring flock is developed and the formats that fill the monitoring as a process.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

